Dhuna në familje kërcënon integritetin fizik dhe psikologjik të atyre që e kanë përjetuar atë.¹⁰ Megjithatë, shkaqet e këtij fenomeni janë të shumtë dhe të ndryshëm. Një teori e përgjithshme është se ekziston një ndarje hierarkike në mes të burrave dhe grave në shoqëritë patriarkale.¹¹ Një shoqëri patriarkale është ajo në të cilën grave dhe burrave u caktohen role të rrepta gjinore, duke i vendosur gratë në një pozitë nënshtruese ndaj burrave. Në mënyrë tipike, burrat konsiderohen se marrin rrogë dhe marrin vendime, ndërsa gratë e kanë rolin e tyre për të rritur fëmijët dhe për t'u kujdesur për shtëpinë.¹² Këto dallime në rolet sipas gjinisë kontribuojnë në kryerjen e veprave të dhunës ndaj grave, meqë dhuna në familje është një fenomen i bazuar në gjini ku ndarja hierarkike sipas gjinisë manifestohet përmes dhunës. Si në shumë shoqëri tjera, Kosova anon kah rolet gjinore patriarkale të cilat shpesh burrave u mundësojnë të shfaqin pushtetin e tyre ekzekutiv në shtëpi e që nga ana tjetër i rritë gjasat për paraqitjen e dhunës kundër grave në kuadër të marrëdhënieve në familje. Kjo veçanërisht

¹⁰ Mooney, J. (2000). *Gjinia, Dhuna, dhe Rendi Shoqëror*. New York: St. Martin's Press, f.155.

¹¹ Dobash, R. P., & Dobash, R. E. (1979). *Violence Against Wives: A Case Against the Patriarchy*. New York: Free Press, p.15.

¹² Lips, H.M. (2014). *Gender: The Basics*. London: Routledge, p.124.

vlen për mjediset rurale, ku rolet tradicionale sipas gjinisë janë më të përhapura sesa nëpër mjediset urbane.¹³

Konflikti në Kosovë, po ashtu ka ndikuar në kryerjen e veprave të dhunës kundër grave. Si në çdo shoqëri të pas-konfliktit, rritja e dhunës në baza gjinore (duke përfshirë përdhunimin, dhunën në familje, trafikimin seksual dhe ngacmimin seksual), ndërsa mungesa e sundimit të ligjit nënkuptonte se kryesit e veprave të dhunës në familje sipas gjitha gjasave mbeteshin pa u ndëshkuar.¹⁴ Megjithatë, pas luftës, organizatat e grave nga shoqëria civile filluan me rritjen e vetëdijesimit për dhunën e bazuar në gjini dhe filluan të llobojnë për barazi gjinore në Kosovë.¹⁵ Janë arritur përparime, dhe luftimi i dhunës kundër grave nuk është më një ‘tabu’ sikurse që ishte rasti para luftës.¹⁶

Kushtet e dobëta socio-ekonomike,¹⁷ duke përfshirë shkallën e lartë të papunësisë dhe metodat e përhapura të ekonomisë jo formale¹⁸ i kontribuojnë dhunës në familje. Për shembull, frustrimi në rritje i përjetuar nga mbajtësit e familjes kur ata nuk ishin në gjendje për t’u kujdesur për familjet e tyre mund të çojnë deri te rritja e gjasave për shfaqje të dhunës, meqë burrat e shprehin zemërimin dhe frustrimin në mënyrë më fizike sesa gratë.¹⁹ Shfrytëzimi tradicional i roleve gjinore dhe kryerja e veprave të dhunës në familje në të vërtetë i parandalon familjet që të dalin nga varfëria. Gratë mund të parandalohet që të kërkojnë punësim dhe dhuna në familje po ashtu mund të çojë deri te rritja e shpenzimeve të përkujdesjes shëndetësore.²⁰ Deprivimi ekonomik i parandalon personat të cilët përjetojnë dhunë në familje për t’u larguar nga mjedisi abuzues, meqenëse viktimat mund të mos jetë në gjendje të mbështes ekonomisht veten dhe fëmijët, pa pasur një asistencë.²¹ Përgjithësisht, kjo mund të çojë deri te një rreth i mbyllur i dhunës në familje.

¹³ Intervistë me një hetues të specializuar të PK për dhunën në familje (2015).

¹⁴ Kosovar Gender Studies Centre. (2008). *History is Herstory Too: The History of Women in Civil Society in Kosovo 1980-2004*. Pristina: Kosovar Gender Studies Centre, pp.275-276.

¹⁵ *History is Herstory Too*, p.280 and 283.

¹⁶ *History is Herstory Too*, p.295.

¹⁷ Buzawa, E.S., Buzawa, C.G., and Stark, E. (2012). *Responding to Domestic Violence: The Integration of Criminal Justice and Human Services*. London: SAGE Publications, p.107.

¹⁸ Komisioni Evropian. (2014). *Raporti i Progresit për Kosovën*, f.24.

¹⁹ As cited in *Gender: The Basics*, p.120.

²⁰ *Responding to Domestic Violence*, p.107.

²¹ Intervistë me hetuesin e specializuar të PK për dhunën në familje (2015).

Përfundimisht, është me rëndësi të theksohet se tiparet personale dhe përvojat jetësore luajnë një rol të rëndësishëm në shkaqet e këtij fenomeni.²² Në përgjithësi, është evidente se Kosova dhe përgjegjësit ndaj dhunës në familje, duke përfshirë institucionet e sundimit të ligjit dhe shërbimet për rehabilitim, ballafaqohen me sfida të mëdha shoqërore, historike dhe socio-ekonomike në tejkalimin e pengesave për parandalimin e dhunës në familje. Prandaj, është imperativ që këto institucione dhe shërbime të jenë të mbështetura në mënyrë adekuatë dhe të përgatitura për të plotësuar kërkesat e viktimave.

Kur një individ i është nënshtruar dhunës në familje siç është e përcaktuar me ligj, sjelljet e kryesve të veprës mund të kufizohen përmes mjetit të Urdhrit për Mbrojtje (tutje, UM), Urdhër për Mbrojtje Emergjente (tutje, UME) ose Urdhër për Mbrojtje Emergjente të Përkohshme (tutje, UMEP). Një UM, është urdhër për mbrojtje i lëshuar me vendim gjyqësor, me të cilin për shembull, kryesit të veprës i ndalohej t'i afrohet viktimës së dhunës në familje ose kryesi i veprës largohet nga vendi në të cilin viktimë dhe kryesi i veprës kanë bashkëjetuar. Një UME lëshohet përkohësisht me vendim të gjykatës. Pas lëshimit të UME, duhet të mbahet një seancë dëgjimore në gjykatë brenda afatit prej tetë (8) ditëve kur edhe UME i skadon afati dhe merret vendimi për çështjen e UM. Një UMEP është urdhër i lëshuar nga policia pas orarit të punës së gjykatave, dhe skadon ditën e nesërme të punës. Gjykata komunale e ka juridiksionin e lëshimit të UM në komunën ku viktimë e ka vendbanimin. Kundër kryesve të veprës mund të lëshohet edhe urdhri për trajtim psiko-social ose trajtim mjekësor për persona të varur nga alkooli dhe nga substancat psikotropike. Një shkelje e UM, UME ose UMEP përbën vepër penale dhe bën që kryesi i veprës t'i nënshtrohet arrestimit dhe ndjekjes penale.²³ *Kodi Penal i Republikës së Kosovës*²⁴ (tutje, KPK) zbatohet pas shkeljes së ndonjërit prej urdhrave mbrojtës, ose për ndonjë vepër tjetër penale të kryer në kontekstin e incidentit të dhunës në familje. Për shkak të dhunës së shkaktuar brenda marrëdhënies në familje, KPK e lejon kategorizimin 'viktimë e cenueshme' për ata që e kanë përjetuar atë. KPK përfshin ndëshkimet përkatëse për veprat penale dhe i kushton kujdes të veçantë krimeve të cilat kryhen kundër partnerëve në familje, duke e specifikuar ndëshkimin për veprat të cilat janë të dallueshme në mjedisin familjar, duke përfshirë kushtet e ngjashme me skllavërinë dhe punën e detyrueshme, përdhunimin, ngacmimin dhe abuzimin seksual të

²² Dutton, D.G. and Bodnarchuk, M. (2005). 'Through a Psychological Lens: Personality Disorder and Spouse Assault. In: Loseke, D.R., Gelles, R.J. and Cavanaugh, M.M. (eds.). *Current Controversies on Family Violence, Second Edition*. Newbury Park: Sage, p.5.

²³ Ligji Nr. 03/L-182: Neni 2, Neni 3, Neni 4, Neni 5, Neni 6, Neni 9, Neni 18, Neni 22, dhe Neni 25.

²⁴ Kodi Nr.04/L082.

personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç.²⁵ Megjithatë, vepra më e zakonshme penale e kryer si pjesë e dhunës në familje është ajo e ‘lëndimit të lehtë trupor’.²⁶ PK-ja shpesh është e para që i përgjigjet incidenteve të dhunës në familje, ndërsa nëse janë kryer edhe vepra penale, PTHK-ja janë përgjegjësit e dytë të cilët informohen. Kështu, këta aktorë përfaqësojnë vijën e parë mbrojtëse të përgjigjes ndaj dhunës në familje përmes të cilës viktimat mund të kenë qasje në drejtësi për krimet të cilat janë kryer kundër tyre.²⁷

Në kuadër të Policisë së Kosovës, Drejtoria për Hetimin e Krimeve të Rënda merret me incidentet e dhunës në familje. Kjo drejtori ka njësi të specializuara policore për t’u përgjigjur ndaj dhunës në familje.²⁸ Në nivelin qendror, ekziston shefi i Sektorit për Dhunën në Familje, dhe hetuesit e specializuar për dhunën në familje.²⁹ Në nivelin rajonal, ka hetues të specializuar për dhunën në familje dhe një numër i specializuar i mbikëqyrësve në shtatë (7) rajonet policore, si në: Ferizaj, Gjakovë, Gjilan, Mitrovica, Pejë, Prishtinë dhe Prizren.³⁰ Ndonëse gjithë pjesëtarët e PK marrin trajnime për dhunën në familje gjatë shkollimit të tyre në Akademinë për Siguri Publike në Vushtrri, policia e specializuar pranon trajnime më intensive për temat e ndryshme të kësaj fushe.³¹ Përgjegjësitë e PK-së janë të përfshira në Nenin 24 të *Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje*. Policia duhet të përgjigjet ndaj të gjitha raportimeve për dhunën në familje dhe të arrestojë kryesin e pretenduar të veprës në pajtim me ligjin (shih *Figura 2* për një pasqyrë të shkurtë). Policia po ashtu duhet të kryej edhe disa veprime tjera, duke përfshirë mes tjerash informimin e viktimës për të drejtat e tij/saj, informimin e ofruesve të shërbimeve përkatëse për rastin, sigurimin e transportit për viktimën në qendrën mjekësore dhe sigurimin e transportit për viktimën për në strehimore, nëse kjo kërkohet nga viktimat.³²

²⁵ Kodi Nr.04/L082: Neni 120, Neni 169, Neni 230, Neni 232, dhe Neni 235.

²⁶ Intervistë me hetuesin e specializuar të PK për dhunën në familje (2015).

²⁷ Intervistë me hetuesin e specializuar të PK për dhunën në familje (2015).

²⁸ Intervistë me shefin e PK të nivelit qendror për Dhunën në Familje (2015).

²⁹ Agjencia për Barazi Gjinore, Zyra e Kryeministrit, Qeveria e Kosovës. (2013).

Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje në Kosovë, Prishtinë, f.58.


³⁰ Shënim, në kohën kur ishte bërë studimi, Gjakova ka qenë pjesë e rajonit të Pejës.

Intervistë me shefin e PK të nivelit qendror për Dhunën në Familje (2015).

³¹ Intervistë me shefin e PK të nivelit qendror për Dhunën në Familje (2015).

³² Neni 24 (1-3).

Figura 2. Përgjegjësitë e policisë në pajtim me Procedurën Standarde të Veprimit në Kosovë



Prokurorët nga PTHK-së në kuadër të Zyrës së Prokurorisë së Shtetit kanë juridiksion për të gjitha rastet e krimeve të shkallës së parë, përveç nëse është e specifikuar ndryshe me ligj. PTHK-ja përbëhet nga Departamenti i Përgjithshëm, Departamenti për të Miturit, dhe nga Departamenti për Ndjekjen Penale të Krimeve të Rënda.³³ Në mënyrë tipike, incidentet penale nga rastet e dhunës në familje trajtohen në kuadër të Departamentit të Përgjithshëm. Prokuroritë Themelore janë formuar në Ferizaj, Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prishtinë dhe Prizren. Veprat penale ndiqen penalisht në pajtim me KPK-në dhe *Kodin e Procedurës Penale* (tutje, KPPK),³⁴ i cili thotë se prokurori i shtetit e ka për detyrë që të shqyrtojë provat fajësuese dhe shfajësuese dhe faktet lidhur me veprat penale, dhe sigurohet që të gjitha hetimet të zhvillohen në mënyrë të duhur.³⁵ Nuk ekzistojnë njësi të specializuara për dhunën në familje brenda PTHK-së.³⁶ Megjithatë, në muajt e fundit, janë caktuar personat kontaktues për dhunën në familje, në secilën Prokurori Themelore, në shtatë rajone.³⁷ Qëllimi prapa

³³ Me qasje online në faqen e internetit të Prokurorisë së Shtetit (<http://www.psh-ks.net/?page=2,103>).

³⁴ KPPK Nr.04/L-123

³⁵ KPPK Nr.04/L-123, Neni 48.

³⁶ Intervistë me personin kontaktues për dhunën në familje nga PTHK (2015).

³⁷ Caktimi i koordinatorëve për dhunën në familje ishte vendosur në takimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës të mbajtur më 30 shtator 2014. Ka qenë përgjegjësi e Kryeprokurorit nga secila Prokurori Themelore që caktojë personin kontaktues për dhunën në familje.

personave kontaktues është specializimi në temat e dhunës në familje dhe këshillimi i kolegëve të tyre, dhe jo vetëm të punohet në rastet e dhunës në familje.³⁸


Kodi i Procedurës Penale i Kosovës i specifikon veprimet të cilat kërkohen nga PK-ja dhe prokurorët me rastin e identifikimit të një incidenti të dhunës në familje. Fillimisht, kur policia bëhet me dije për një incident të dhunës në familje, ata duhet të hetojnë nëse rasti përmban ndonjë element penal, gjetjen e kryesit të veprës dhe parandalimin e tij/saj nga ikja, dhe sigurimin e çfarëdo prove të veprës penale. Nëse bëhet fjalë për veprime penale, policia duhet të dorëzojë një raport në PTHK. Prokurorët mund të iniciojnë një fazë hetimore të procedurës penale pas pranimit të arsytimit për dyshim të bazuar nga policia ose nga ndonjë person tjetër. Për rastet si dhuna në familje, kur ‘ekziston dyshimi i arsyeshëm se është kryer një vepër penale, është duke u kryer ose ka gjasa që ajo do të kryhet në një të ardhme të afërt’, këto raste ndiqen penalisht *ex officio*.³⁹ Vendimi për hetimin e incidentit do t’i Vendimi për hetimin e një incidenti duhet t’i specifikojë hollësitë e rastit sipas ligjit, dhe i dërgohet gjyqtarit të procedurës paraprake pa vonesë.⁴⁰ Figura 3 paraqet një pasqyrë të shkurtë të përgjegjësive të prokurorëve gjatë përgjigjes ndaj veprave penale të lidhura me dhunën në familje.

³⁸ Takimi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, i mbajtur më 30 shtator 2014. Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Prokuroritë Themelore deri tani nuk i kanë specifikuar termat e referencës për rolin e personave kontaktues.

³⁹ Ndjekja penale *Ex officio* nënkupton se prokurorët nuk mund ta hudhin poshtë një rast penal i cili ka ndodhur në kontaktin e dhunës në familje, edhe kur viktima kërkon që rasti të hudhet poshtë. Krimi i vetëm i cili përjashtohet nga ndjekja penale *ex officio* që lidhet me rastet e dhunës në familje është kërcënimi (KPPK, Neni.185).

⁴⁰ KPPK Nr.04/L-123: Art.70, Art.80, Art.101, Art.102, Art.104.

Figura 3. Përgjegjësitë e Prokurorit në pajtim me Procedurat Standarde të Veprimit në Kosovë



Për shkak të natyrës komplekse të rasteve të dhunës në familje, është esenciale që përgjigjet nga institucionet e vijës së parë jenë unike, të bashkërenduara dhe në pajtim me ligjin.⁴¹ Një numër i përpjekjeve janë bërë gjatë viteve të fundit për të arritur përgjigje të tilla në Kosovë. Është themeluar një strukturë institucionale në kuadër të Kordinatorit Nacional kundër Dhunës në Familje e cila synon parandalimin e dhunës në familje dhe përmirësimin e përgjigjeve për viktimat në kuptim të mbrojtjes, rehabilitimit dhe reintegrimit..⁴² Mes viteve 2011 dhe 2014, *Programi Kosovar kundër Dhunës në Familje dhe Plani i Veprimit* kanë punuar në këto synime me ministrinë e ndryshme të Kosovës. Ministrinë, institucionet dhe organizatat.⁴³ Një Kordinator i ri kundër Dhunës në Familje ishte emëruar në fillim të vitit 2015. Megjithatë, një strategji pasuese kundër dhunës në familje ende duhet të hartohet.⁴⁴ Po ashtu janë zhvilluar një numër i veglave për ta ndihmuar përgjigjen e drejtësisë ndaj dhunës në familje që ajo të jetë e standardizuar. *Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje në Kosovë* (tutje, PSV; 2013) ishin zhvilluar dhe shpërndarë në të gjitha

⁴¹ Intervistë me hetuesin e specializuar të PK për dhunën në familje (2015).

⁴² Ministria e Drejtësisë, Zyra e Kordinatorit Nacional kundër Dhunës në Familje. (2012). *Aktivitetet kundër Dhunës në Familje: Raporti Vjetor i Progresit*. Prishtinë: Ministria e Drejtësisë, f.10.

⁴³ *Aktivitetet kundër Dhunës në Familje: Raport Vjetor i Progresit*, f.12.

⁴⁴ Intervistë me PK, Zyrën për Avokim dhe drejtorin e strehimores (2015).

institucionet relevante, duke siguruar kështu një udhërrëfyes për përgjigjet më të mira ndaj dhunës në familje. PSV-ja siguron një përshkrim të përgjegjësive dhe të praktikave të mira të cilat duhet të zbatohen nga përgjegjësit e ndryshëm ndaj dhunës në familje, duke e përfshirë PK dhe prokurorët. Ajo paraqet një udhëzues të dobishëm për bashkërendim përmes përshkrimit të aspekteve të ndryshme të një rasti të dhunës në familje mbi të cilin veprimet duhet të funksionojnë në tandem, dhe përfshin një numër të formave dhe listave kontrolluese të cilat mund të përdoren aktorë të ndryshëm me qëllim të përmirësimit të vlerësimit të tyre për incidentet e dhunës në familje.⁴⁵ Në fund, *Komentari për Ligjin për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje* (2014), elaboron për të ligjin civil të Kosovës mbi dhunën në familje, me qëllim të qartësimit se si duhet të interpretohet në mënyrë të saktë.⁴⁶ Aty thuhet se për shkak të miratimit rishtazi të tij, atij i ‘mungon një teori e zhvilluar dhe një praktikë e qëndrueshme...’⁴⁷ Në dritën e zbrazëtirave në zbatimin e ligjit, *Komentari* synon eliminimin e çfarëdo përgjigjeve të dobëta për shkak të keqinterpretimit. Vlen të theksohet se iniciativat tjera të numërta për dhunën në familje janë implementuar gjatë viteve të fundit nga organizatat ndërkombëtare, organizatat e shoqërisë civile, ministritë dhe institucionet tjera. Megjithatë, një analizë e këtyre iniciativave do të shkonte përtej fushës së këtij hulumtimi.

Me dhënien e një përvijimi të shkurtë të historikut të dhunës në familje në Kosovë, dhe të institucioneve dhe kornizës ligjore të hartuar për luftimin e këtij fenomeni, ky dokument ka për synim vlerësimin e gjendjes aktuale në PK dhe PTHK të përgjigjeve ndaj dhunës në familje. Përveç një Kordinatori Nacional kundër Dhunës në Familje të emëruar së fundi, ekzistojnë edhe personat kontaktues brenda PTHK-së për dhunën në familje, ndërsa PK-ja i ka njësitë e specializuara për trajtimin e dhunës në familje. Kështu, një përkushtim i përtërirë për eliminimin e dhunës në familje, dhe mbështetjen dhe shfrytëzimin e strukturave dhe institucioneve të disponueshme, mund të përmirësojë përgjigjet ndaj dhunës në familje. Ky raport synon mbështetjen e këtij procesi. Hulumtimi kualitativ nënvizon një numër të fushave kyçe në të cilat përgjigjet nga PK-ja dhe PTHK-ja janë të suksesshme dhe i jep rekomandimet për fushat në të cilat përgjigjet kanë nevojë për përmirësim.

⁴⁵ *Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje në Kosovë*, f. 30, 43, 57.

⁴⁶ H. Gashi, dhe R. Berisha, (2014). *Komentari për Ligjin për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje*.

Prishtinë: Agjencia për Barazinë Gjinore, Zyra e Kryeministrit, Qeveria e Kosovës.

⁴⁷ *Komentari për Ligjin për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje*, f.6.

METODOLOGJIA

Hulumtimi kualitativ është zhvilluar duke i përdor intervistat gjysmë të strukturuar dhe pyetësorët me personelin e PK-së dhe PTHK-së, dhe janë plotësuar me intervista nga një numër palësh tjera me interes. Për më tepër, hulumtimi përfshin një studim të rastit nga incidentet e dhunës në familje nga jeta reale, dhe përgjigjet të cilat PK-ja dhe prokuroria i kanë marrë si rezultat.

Pjesëmarrësit

Personeli nga PK-ja dhe PTHK-ja ishin zgjedhur si pjesëmarrës për këtë hulumtim për shkak të nga vija e parë të cilin e kanë në përgjigje të rasteve të dhunës në familje, si dhe të shkathtësisë, njohurisë dhe ekspertizës. Pjesëmarrësit individual konsideroheshin të jenë ekspertë të fushës përkatëse dhe ishin përzgjedhur në bazë të njohurive të tyre për funksionimin e PK-së ose PTHK-së në secilin rajon, apo për shkak të njohurive të tyre specifike si persona përgjigjes ndaj rasteve të dhunës në familje në Kosovë. Për shkak të natyrës së hollësishme kualitative të intervistave, EULEX-i përcaktoi se numri i personelit që ishte intervistuar ishte i mjaftueshëm për të fituar një pasqyrë të përgjithshme të gjendjes aktuale të përgjigjeve të këtyre institucioneve ndaj dhunës në familje. Hulumtuesit i kanë kontaktuar pjesëmarrësit përmes telefonit ose Emailit për të shpjeguar qëllimin e hulumtimit dhe organizimin e intervistës. Një numër i pjesëmarrësve kishte kërkuar që identiteti i tyre të mbahej i fshehtë për qëllime të këtij hulumtimi. Prandaj, këta individë referoheshin sipas titullit të tyre profesional.

Policia e Kosovës: Pjesëmarrësit e intervistuar nga PK-ja janë listuar, si vijon:

- Gjashtë (6) Komandantë të Stacioneve të Policisë së PK-së dhe gjashtë (6) hetues të PK-së të specializuar për dhunën në familje që ishin nga rajonet: Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë, Pejë,⁴⁸ Prishtinë dhe Prizren. Shefi i Nivelit Qendror për Dhunën në Familje
- Shefi i Njësisë Hetimore në Gjilan
- Hetuesi Parësor për Dhunën në Familje në Gjilan
- Kordinatori për Dhunën në Familje në Prishtinë

⁴⁸ Në kohën e hulumtimit, policia nga rajoni i ri i Gjakovës ishte mbuluar nga policia e rajonit të Pejës.

Veç atyre që kanë marrë pjesë në ‘Detyrën për Dhunën në Familje’, pjesa tjetër e intervistave të pjesëmarrësve nga PK-ja ishin strukturuar rreth një grupi pyetjesh bazike (shih *Shtojca A*). Lexuesit do të vërejnë fokusimin e PK-së nga rajoni i Gjilanit. Kjo qasje ishte përzgjedhur me qëllim të pranimit të informacionit prej niveleve të Zinxhirit Komandues në njësinë e PK-së të specializuar për dhunën në familje. Përfundimisht, Shefja nga Niveli Qendror për Dhunën në Familje është përzgjedhur për shkak të njohurisë së saj për përgjigjet e PK-së ndaj dhunës në familje. Përveç pyetjeve të cilat gjenden në *Shtojca A*, Shefja për Dhunën në Familje ka marrë edhe një pyetësor pasues (shih *Shtojca B*).

Prokuroritë Themelore të Kosovës: Pjesëmarrësit parësor nga PTHK-ja ishin prokurorët e emëruar si persona kontaktues në secilën Prokurori Themelore në rajon, Ferizaj, Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prishtinë dhe Prizren. Një prokuror shtesë me përvojë në rastet e dhunës në familje po ashtu ishte intervistuar në Gjilan, me tetë (8) prokurorë të intervistuar. Personat kontaktues ishin përzgjedhur si pjesëmarrës për këtë hulumtim për shkak se ishin emëruar rishtazi si pika kontaktuese për dhunën në familje (tetor 2014). Ata janë përgjegjës për rastet e përgjigjeve nga prokurorët ndaj rasteve të dhunës në familje në rajonet e tyre. Intervistat bazoheshin në numrin e pyetjeve mostër (shih *Shtojca C*).

Kontrollet: Për të siguruar kontrollin për intervistat me PK-në dhe PTHK-në, ishin intervistuar edhe një numër individësh:

- Shefi i Zyrës për Avokim dhe Ndihmë për Viktimat (tutje, ZANV; shih *Shtojcën D*)
- Drejtori i Strehimores për Gratë (shih *Shtojca E*)
- Gjyqtari civil në kuadër të Gjykatës Themelore (shih *Shtojca F*)

Shefi i ZANV ishte përzgjedhur për shkak të rolit të rëndësishëm Avokatit të Viktimës në procesin gjyqësor për viktimat e dhunës në familje, raportet e tyre të ngushta të punës me PTHK-në dhe bashkërendimin e tyre të rregullt me PK-në. Drejtori i Strehimores për Gratë ishte përzgjedhur për të përfshirë edhe perspektivën nga një institucion që merret për së afërmi me dhunën në familje dhe që ka një këndvështrim tjetër për punën e policëve dhe prokurorëve. Përfundimisht, gjyqtari civil është përzgjedhur për shkak të përvojës së gjyqtarit për lëshimin e UP për viktimat e dhunës në familje.

Intervistat

Në fillim të secilës intervistë, pjesëmarrësit informoheshin me gojë për qëllimin e hulumtimit dhe ata dhanë pëlqimin e tyre për të marrë pjesë. Siç ishte cekur, intervistat ishin gjysmë të strukturuar dhe ishin zhvilluar rreth grupeve themelore të pyetjeve. Hulamtuesit lejonin që intervista të udhëhiqej nga pjesëmarrësit, duke lejuar një ecure të natyrshme në mes të temave dhe për përfshirjen e çfarëdo informacioni shtesë të rëndësishëm dhe relevant. Për shkak të barrierës gjuhësore në mes të hulamtuesve (anglez) dhe pjesëmarrësve (shqiptarë/serbë), ishte angazhuar një asistent gjuhësor për të lehtësuar intervistat. Hulamtuesit e shënuan me dorë informacionin e dhënë nga pjesëmarrësit.

Rast Studimor

Kronikat nga rasti “X” përbëhen prej një numri të incidenteve nga jeta reale të cilat kishin ngjarë në kontekst të një marrëdhënie abuzuese në familje, në Kosovë dhe përgjigjet që ishin si rezultat i PK-së, PTHK-së dhe gjykatave. Për krimet e kësaj natyre ishte informuar edhe EULEX Kosova kur kishte pranuar një kërkesë me shkrim për mbështetje nga një viktimë e incidenteve të pretenduara. Për shkak të natyrës serioze të sjelljes së pretenduar të keqe të institucioneve të Kosovës, EULEX-i zhvilloi një hetim për veprimet të cilat ishin marrë në përgjigje ndaj incidenteve të dhunës në familje. Rasti “X” është përfshirë në këtë raport si një mostër krahasuese për intervistat me PK-në dhe PTHK-në.

Analiza

Analiza tematike ishte përdorur për ekzaminimin e të dhënave të mbledhura. Temat më pas ishin ekzaminuar më tutje përgjatë dhe nëpër institucione për të përcaktuar ngjashmëritë dhe dallimet më të qarta në mes të rajoneve/stacioneve/zyrave. Tetë tema janë gjetur nga përgjigjet nga PK-ja: Legjislacioni dhe Politikat; Procesi Hetimor; Bashkërendimi; Mbledhja e të Dhënave; Përgjigjet Efektive ndaj Dhunës në Familje; dhe Fushat për Përmirësim. Gjashtë tema janë gjetur nga përgjigjet prej personave kontaktues në PTHK për dhunën në familje. Përvoja dhe Roli i Personave Kontaktues për Dhunën në Familje; Procesi i Ndjekjes Penale; Bashkërendimi; Mbledhja e të Dhënave; Përgjigjet Efektive ndaj Dhunës në Familje; dhe Fushat për Përmirësime.

Kufizimet e Hulamtimit

Ekziston një numër i kufizimeve për këtë hulumtim të cilat mund të merren në konsideratë nga projektet e ardhshme hulamtuese:

- Kuptimi nga shoqëria i mandatit të EULEX-it në Kosovë mund të ketë ndikuar tek pjesëmarrësit që të paraqesin një pasqyrë më të favorshme për përgjigjet aktuale ndaj dhunës në familje. Në përgjithësi është e vështirë të shmanget një paragjykim i tillë, por hulumtuesit janë munduar ta sfidojnë këtë përmes kontrollit të intervistave me shefin e ZANV, drejtorin e Strehimores për Gratë dhe gjyqtarin civil, duke ofruar kështu një balans dhe bashkëpunim.
- Meqenëse ky studim ishte zhvilluar nën kufizime kohore, nuk ka qenë e realizueshme që të intervistohen edhe pjesëtarë shtesë nga policia në komunitet, prokurorët ose avokatët e viktimave. Prandaj, personeli me përvojë të gjerë me përgjigje ndaj dhunës në familje mund të mos e ketë pasur mundësinë për të dhënë kontributin e tyre. Një projekt i një shkalle më të gjerë do të mund t'i plotësonte këto zbrazëtira.
- Do të ishte e natyrës informuese sikur viktimat e dhunës në familje të intervistoheshin prej tyre, në mënyrë që të kuptoheshin përvojat e PK-së dhe PTHK-së ndaj dhunës në familje. Megjithatë, për shkak të natyrës së ndjeshme të këtyre intervistave, potencialit për ri-traumatizim të viktimave dhe kohës së kufizuar të këtij studimi, ishte vendosur që burime dytësore të informacionit do të ishin më të përshtatshme për qëllimet e këtij hulumtimi.

REZULTATET dhe ANALIZA

Pjesa në vazhdim e paraqet informacionin i cili ishte mbledhur nga PK-ja dhe PTHK-ja, i paraqitur sipas temave të cilat ishin vërejtur gjatë analizës së të dhënave. Numri i pjesëmarrësve që e kishte siguruar të njëjtin informacion është i paraqitur në kllapa. Për shembull, nëse dy pjesëtarë nga PK-ja kanë dhënë deklaratat plotësuese, kjo paraqitur si (n=2). Kjo metodë përdoret për të treguar fuqinë e deklaratës dhe lexuesit i siguron një indikacion se për sa një deklaratë mund të përgjithësohet që të tregojë një praktikë të zakonshme në Kosovë.

Pjesa nga ‘Përgjigjet e Policisë’ është në bazë të të dhënave dhe nga analiza e tyre për ‘Detyrën për Dhunën në Familje’ nga EULEX-i, intervistat me hetuesit e PK-së të specializuar për dhunën në familje dhe pyetësi i plotësuar nga Shefi i Nivelit Qendror për Dhunën në Familje i PK-së. Pjesa me ‘Përgjigjet e Prokurorëve’ është përpiluar nga të dhënat, analiza e tyre, intervistat me personat kontaktues për dhunën në familje në kuadër të PTHK-së. Përfundimisht, pjesa e fundit, e quajtur ‘Kontrolli i Përgjigjeve’, është në bazë të të dhënave prej intervistave me shefin e ZANV-së, drejtorin e strehimores për gratë dhe gjyqtarin civil në kuadër të Gjykatës Themelore.

Përgjigjet e Policisë

Tema 1: Legjislacioni dhe Politikat

Përgjigja e përgjithshme lidhur me kornizën ligjore për përgjigjet ndaj dhunës në familje është se *Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje*, KPK dhe KPPK sigurojnë mbrojtje të mjaftueshme ligjore (*de jure*) për viktimat e dhunës në familje, dhe udhëzime të mjaftueshme për institucionet e sundimit të ligjit se si të lehtësohet kjo mbrojtje (n=6). Megjithatë, pjesëmarrësit janë shprehur se problemet kanë dalë gjatë përpjekjeve për të siguruar mbrojtjen e viktimave në praktikë (*de facto* mbrojtje; n=6). Siç do të duket qartë përgjatë rezultateve të këtij hulumtimi, faktorë të shumtë i kanë kontribuar zbrastërës në mes të legjislacionit dhe implementimit. PSV-ja e KP-së siguron udhëzime shtesë për përgjegjësit nga vija e parë për mbështetjen e përgjigjeve të tyre ndaj dhunës në familje. Prej shtatë (7) stacioneve të cilat kanë marrë pjesë në intervista, gjashtë (6) ishin në dijeni të ekzistimit të PSV-së dhe punës në përputhje me dispozitat e saj. Për dallim, komandanti i stacionit i intervistuar në pjesën veriore të Kosovës nuk ishte në dijeni të ekzistimit të PSV-së dhe

kishte deklaruar se rastet e dhunës në familje trajtohen njësoj sikurse rastet tjera në këtë stacion.

Analiza: *Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje* siguron një kornizë ligjore pas rregullore së mëhershme për dhunën në familje të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK)⁴⁹ lejon aplikimin e ligjit penal në shkelje të UM civile. Më tej, KPK i ri dhe KPPK i ri lejon statusin e ‘viktimit të cenueshme’ për ata të cilët përjetojnë dhunë në mjedisin familjar. Këto ligje, veç PSO-s për dhunën në familje, duket se e udhëzojnë PK-në në përgjigjet e saja ndaj dhunës në familje. Megjithatë, përkundër legjislacionit adekuat, përgjigjet ndaj dhunës në familje nganjëherë janë të pakta nëse ato nuk standardizohen në mënyrë të mjaftueshme në gjithë policinë. *Komentari për Ligjin për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje* thotë se ‘Ligjit të ri ende i mungon një teori e zhvilluar dhe një praktikë e qëndrueshme’.⁵⁰ Edhe pse e gjithë policia pranon trajnime për dhunën në familje në Akademinë për Siguri Publike në Kosovë, përpjekjet në të gjitha nivelet e PK-së duhet të fokusohen në sigurimin që ndaj të gjitha incidenteve të dhunës në familje të ketë përgjigje korrekte. Nga ky hulumtim paraprak, bashkë me të dhënat e krimeve të regjistruara duket se një fokus i veçantë duhet të vendoset në përgjigjet e PK-së ndaj dhunës në familje në pjesën veriore të Kosovës. Hulumtimi i mëtejshëm mund të konstatojë nëse përgjigjet e dobëta ndaj dhunës në familje në një stacion mund të shtrihen edhe në stacionet tjera. Edhe pse viteve të fundit PK-ja në pjesën veriore të Kosovës është ballafaquar me sfida për shkak të integritetit të njësive të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë (MPB), PK-ja duhet t’i dyfishojë përpjekjet për të siguruar se policia atje e zbaton legjislacionin e Kosovës dhe PSO-në për dhunën në familje.

Tema 2: Procesi hetimor

Intervistat kërkojnë përcaktimin e një procesi tipik hetimor të PK-së ndaj incidenteve të dhunës në familje. Njësitë hetimore për dhunën në familje janë të vendosura në stacione në të gjitha nivelet e PK-së dhe përbëhen prej hetuesve policor vendës të specializuar për dhunën në familje. Fillimisht, rastet trajtohen në nivel të stacionit. Rastet më të rënda mund të transferohen në nivel të rajonit. Për shembull, nëse shumë raste kanë të bëjnë me individë të njëjtë janë raportuar në stacione të ndryshme brenda rajonit, njësitë hetimore e nivelit rajonal

⁴⁹ Rregullorja Nr. 2003/12.

⁵⁰ *Komentari për Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje*, f.6.

do ta marr rastin. Në nivelin rajonal, një ekip për dhunën në familje është i gatshëm që në bazë të thirrjes të përgjigjet ndaj incidenteve.

Rajoni i Gjilanit është një shembull përfaqësues i plotësimit me staf në nivel rajonal dhe atë të stacioneve të PK-së nga specialistët për dhunën në familje, të paraqitur në *Tabelën 1*.

Tabela 1. Numrat e Njësive të PK-së kundër Dhunës në Familje në Gjilan

Rajoni (R) / Niveli i Stacionit (S)	Numri i Hetuesve të Specializuar kundër DHF
Gjilan (R)	2
Gjilan (S)	2
Kamenicë (S)	2
Klokot (S)	2
Novobërdë (S)	1
Partesh (S)	1
Ranillug (S)	2
Viti (S)	1

Pjesa në vazhdim paraqet një pasqyrë të përgjigjeve të patrullave të PK-së dhe hetuesve të specializuar për incidentet e dhunës në familje, e paraqitur sipas renditjes kronologjike me mënyrën se si duhet të realizohen përgjigjet në pajtim me legjislacionin e Kosovës dhe PSV-në. Si më herët, numri i pjesëmarrësve të cilët e kanë përmendur praktikën e dhënë janë është i paraqitur në kllapa.

Kur një incident i dhunës në familje raportohet për herë të parë, një patrullë e PK-së dërgohet menjëherë vendngjarje (n=2). Një police është gjithmonë në kuadër të patrullës e cila dërgohet në vendngjarje e dhunës në familje, dhe ajo qëndron në vendngjarje derisa të arrijë hetuesi i specializuar për dhunën në familje (n=1). Nga një police që është përgjegjëse për hetimin e dhunës në familje është kujdestare 24/7 (n=3) dhe kjo vlen për çdo stacion. Kur patrulla përcakton se incidenti i dhunës në familje vërtetë ka ndodhur, hapësira sigurohet dhe hetuesi i specializuar për dhunën në familje dhe ekipi i forenzikës lajmërohen për të ardhur në vendngjarje (n=3). Çdo incident i dhunës në familje i cili ndodhë në rajon hetohet, pavarësisht rajonit prej nga është viktimja ose kryesi i veprës (n=1). Nëse ka shenja të abuzimit fizik, viktimja dërgohet në spital për vlerësim (n=2) ku çfarëdo shenje e abuzimit fotografohet dhe vërtetohet nga mjeku. Kjo provë pastaj i bashkëngjitet dosjes së policisë

(n=1). Shpesh, hetuesi e shoqëron viktimën në spital. (n=3). Pas kësaj, policia i njofton institucionet tjera relevante, kryesisht ZANV-në dhe Qendrën për Mirëqenie Sociale (n=2). Avokati i viktimës është gjithmonë i pranishëm gjatë kohës kur viktimja jep deklaratën e vet para policisë (n=3). Dëshmitë e dhëna nga viktimat për dhunën në familje trajtohen si të ndjeshme (n=3). Viktimja dhe kryesi i veprës gjithmonë janë të ndarë gjatë dhënies së intervistave të tyre (n=1). Edhe pse viktimat këshillohen që të japin deklaratën në polici, ato kurrë nuk detyrohen që ta bëjnë këtë (n=3). Nëse nuk kanë ndodhur vepra penale në incident, policia gojarisht do të përcaktojë hollësitë e rastit, nëse viktimat nuk dëshirojnë të japin deklaratë me shkrim (n=2). Raportet me shkrim ndahen me Avokatin e Viktimës dhe Qendrën për Mirëqenie Sociale (n=2). Nëse është e nevojshme, gjykatës i dërgohet një kërkesë për një UM ose një UME. Jashtë orarit të rregullt të punës së gjykatave, policia mund të lëshojë një UMEP (n=7). Kur gjykata e lëshon një UM, policia si dhe viktimja e marrin nga një kopje (n=1). Policia përgjegjëse në Zonën e Përgjegjësisë (ZeP) i kanë kopjet e UM-ve dhe, kurdo që teknikisht është e mundur, e kontakton viktimën herë pas herë për të përcjellë gjendjen e tyre të sigurisë (n=2). Nëse veprat penale të kryera janë pjesë e incidentit të dhunës në familje, atëherë informohet prokurori (n=6). Raportet për veprat penale gjithmonë u dërgohen prokurorëve pavarësisht kundërshtimeve nga ana e viktimave (n=4). Policia i arreston kryesit e incidenteve të dhunës në familje, dhe me urdhër të prokurorit, ata intervistohen. Pas paraqitjes së raportit për prokurorin, njësi hetimore i merr të dhënat më të reja për procedurën e rastit nga prokurorët dhe gjykatat (n=1). Nganjëherë, hetuesve policor u kërkohet që të jenë të pranishëm në seancat gjyqësore ose mund të thirren si dëshmitarë (n=1). Nëse kundër një polici të PK-së paraqitet një ankesë për kryerjen e veprës së dhunës në familje, rasti inicohet nga PK-ja, e më pas i dorëzohet Inspektoratit Policor të Kosovës (IPK); (n=1). Ekziston një linjë telefonike për viktimat e dhunës në familje, e siguruar nga ZANV-ja (n=2).

Pjesëmarrësi i intervistuar në pjesën veriore të Kosovës ka raportuar se në stacion nuk ekziston ndonjë njësi hetimore e specializuar për dhunën në familje, dhe themelimi i një njësie të tillë nuk është i paraparë në një të ardhme të afërt.⁵¹ Atje, njësi e zakonshme për hetimin e krimeve merret edhe me rastet e dhunës në familje. Shtatë (7) prej gjithsej tetëdhjetë e pesë (85) të stafit kanë pranuar trajnime të specializuara për hetues të dhunës në

⁵¹ Ekziston një njësi për dhunën në familje në nivel rajonal në pjesën veriore të Kosovës, me hetues të specializuar për dhunën në familjes; Intervistë me Shefin e Nivelit Qendror për Dhunën në Familje (2015).

familje. Këta individë të trajnuar u kanë kaluar njohuritë e tyre policëve tjerë të cilët punojnë nëpër stacione të policisë në pjesën veriore të Mitrovicës, Zveçan, Zubin potok dhe Leposaviq. Njësitë hetimore të stacioneve policore tjera punojnë në këto raste sipas PSO and legjislacionit të Kosovës.

Jo të gjithë mekanizmat institucional dhe të aktorëve tjerë që janë drejtpërsëdrejti të përfshirë në mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje janë implementuar dhe sistemi SIPK, aktualisht, nuk është implementuar.

Masat e veçanta të cilat janë theksuar për rastet e dhunës në familje në këtë stacion ishin ndarja e viktimës dhe e të dyshuarit gjatë intervistimit, dhe largimi i fëmijëve nga skenat me rrezikshmëri.

Analiza: Rezultatet e paraqitura më sipër ofrojnë vetëm një përfytyrim të shkurtër lidhur me mënyrën e përgjigjes së PK-së në rastet e dhunës në familje në Kosovë. Në mënyrë që të vërtetohet cila mënyrë e përgjigjeve zbatohet rregullisht në rastet e dhunës në familje duhet të mblidhen dëshmi nga secili stacion. Megjithatë, nga intervista është e qartë që policia në përgjithësi është në dijeni lidhur me shumë përgjigje të cilat duhet të zbatohen në pajtueshmëri me legjislacionin dhe me PSO për dhunën në familje. Standardizimi i përgjigjeve të sipërpërmendura në të gjitha stacionet dhe në të gjitha rastet e dhunës në familje në Kosovë do t'iu ofronin viktimave një përgjigje të mirë të policisë.⁵²

Një intervistë me një ekspert me rol udhëheqës ka zbuluar që njësitë për hetimin e dhunës në familje mund të pësojnë ndryshime në të ardhmen e afërt dhe që Drejtoria e Policisë në Bashkësi dhe Parandalimi do të merren me dhunën në familje⁵³. Njësitë e specializuara për hetimin e dhunës në familje janë në pajtim me praktikën e mira për parandalimin dhe hetimin e rasteve të dhunës kundër grave.⁵⁴ Prandaj, është me rëndësi që, pavarësisht nga ndonjë ndryshim brenda strukturës së policisë, dhuna në familje mbetet përparësi dhe që viktimave të dhunës në familje t'ju jepet përgjigje e specializuar. Rekomandohet që njësitë e specializuara ta çojnë deri në fund zbatimin e urdhrave për mbrojtje pasi që të jenë nxjerrë ata.⁵⁵

⁵² Përgjigja homogjene e policisë avokohet në: *European Union Handbook of best police practices on tackling violence against women*, f.8.

⁵³ *Ky ndryshim i raportuar duhet të konfirmohet zyrtarisht nga PK-ja.*

⁵⁴ *European Union Handbook of best police practices on tackling violence against women*, f.7.

⁵⁵ *European Union Handbook of best police practices on tackling violence against women*, f.7.

Standardizimi i kësaj praktike do të garantonte që viktimat marrin mbrojtjen e cila ju ofrohet atyre sipas së drejtës civile.

Për të pasur një përgjigje që merr parasysh viktimësn, është një praktikë e mirë që të jetë e pranishme një hetuese e specializuar për dhunë në familje, në mënyrë që viktima femër ta ketë mundësinë që dëshminë t'ia jap një zyrtareje të policisë të gjinisë së njëjtë.⁵⁶ Megjithatë, duke u bazuar në raportet e PK-së të siguruar nga EULEX Kosova për muajin mars dhe prill 2015, prej gjithsej pesëdhjetë e shtatë (57) rasteve të cilësuar si dhunë në familje, lëndim i lehtë trupor, lëndim i rëndë trupor ose kërcënim, në pesëmbëdhjetë (15) raste përgjegjëse ka qenë një police dhe në njëzet e katër (24) raste ka pasur hetuese policore. Edhe pse kjo nuk ofron dëshmi vendimtare, kjo shtron pyetjen nëse viktimat kanë pasur mundësi të zgjedhjes së polices. Prandaj, përmirësimet në caktimin e policeve që përgjigjen në raste dhe të hetueseve të specializuara për dhunë në familje do ta përmirësonte natyrën e përgjigjes së PK-së ndaj dhunës në familje.

Një praktikë tjetër e mirë që është përmendur ishte ajo e bashkëngjitjes së dëshmimeve fotografike të dhunës fizike në dosjet e rasteve të policisë. Kjo duhet të standardizohet në të gjitha rastet në mënyrë që të sigurohet që prokurorët dhe gjykatat sigurojnë informata shumë relevante lidhur me rastin. Në fund, si edhe më parë, është me rëndësi të jashtëzakonshme që praktikat e mira dhe pajtueshmëria me legjislacionin e Kosovës të zbatohen edhe në Kosovën veriore.

Tema 3: Bashkërendimi

Në përgjithësi pjesëmarrësit shprehën perceptimin e tyre të bashkëpunimit të mirë ndërmjet përgjegjësve të vijës së parë ndaj dhunës në familje (n=6). Të intervistuarit ishin në përgjithësi në dijeni lidhur me aktorët e ndryshëm me të cilët duhet të korrespondojnë me rastet. Tre të intervistuar e përmendën bashkërendimin me prokurorët, avokatët e viktimave, qendrën për punë sociale, spitalet, strehimoret dhe psikologët (n=3). Në përgjithësi, është raportuar bashkëpunimi i rregullt me prokurorët meqë rastet penale duhet të ndiqen penalisht *ex officio* dhe prandaj policia dhe prokurorët duhet rregullisht t'i ndajnë informatat lidhur me rastet (n=6). Shefi për dhunë në familje në nivel qendror ka raportuar që PK dhe Prokuroritë Themelore të Kosovës i ndajnë informatat lidhur me identitetin, moshën dhe gjininë e viktimës, datën dhe kohën e incidentit, ndonjë lëndim fizik, nëse viktima ka fëmijë dhe nëse viktima jeton me kryesin e veprës. Në lidhje me të dyshuarin ndahen informatat të cilat

⁵⁶ Intervistë me shefin për dhunë në familje në nivelin qendror (2015).

regjistrohen lidhur me identitetin e tij dhe ndonjë të kaluar kriminale dhe ndonjë histori e sëmundjes mendore ose e abuzimit të alkoolit. Megjithatë, është thënë që rrallë ndodhë që policia të marrë informata nëse është ngritur aktakuzë apo jo. Ata marrin informata pasuese për rastet nga gjykatat (n=1).

Policia i informon avokatët e viktimave lidhur me rastet e dhunës në familje në mënyrë që ata të mund të marrin pjesë në dëshmitë e viktimës (n=6). Në përgjithësi bashkëpunimi me strehimoret duket i mirë, ndërsa viktimat rregullisht drejtohen në strehimoren në rajonin e tyre (n=4). Vlerësimet e rrezikut të viktimës ndahen me strehimoret (n=2). Policia po ashtu pranon informata kthyese nga strehimorja lidhur me mirëqenien e viktimave (n=1). Kur një viktimë drejtohet për në strehimore, policia e informon qendrën për punë sociale (n=1). Policia bashkërendohet me qendrën për punë sociale në rastet kur kategori të ndjeshme të viktimave janë të përfshira në raste, siç janë fëmijët apo personat me nevoja të posaçme. Bashkërendimi me punëtorët e kujdesit shëndetësor është përshkruar meqë nganjëherë edhe institucionet shëndetësore i raportojnë në polici rastet e dhunës në familje në emër të viktimës (n=1). Ekipet mjeko-ligjore janë të përfshira në rastet që kanë të bëjnë me abuzim seksual apo me vdekjen e viktimës. Për lëndimet trupore shfrytëzohen ekipet e përgjithshme mjekësore (n=2). Duket se bashkërendimi në Kosovën veriore është i dobët. Është raportuar mungesa e organizatave mbështetëse, siç janë strehimoret dhe shërbimet e tjera rehabilituese. Avokatët e viktimave nuk kanë zyrë në Kosovën veriore por janë kujdestarët që udhëtojnë në stacionet e policisë nga zyra e tyre në Mitrovicën jugore. Një çështje e fundit e bashkërendimit që vlen të përmendet është ajo e mekanizmave bashkërendues të komunës të cilët janë themeluar në një numër të rajoneve.⁵⁷ Të intervistuarit nga rajonet e përfshira në këto projekte i kanë vlerësuar projektet si të dobishme për përmirësimin e përgjigjeve ndaj dhunës në familje (n=4). Ata e kanë shprehur dëshirën e tyre për vazhdimin e këtyre aktiviteteve dhe që projekte të ngjashme mund të krijohen në rajonet e tjera (n=2).

⁵⁷ Një pilot projekt, i mbështetur nga UN Women, u vendos në komunën e Dragashit, në atë të Gjakovës dhe të Gjilanit dhe u zhvillua prej vitit 2011 deri më 2014. Në projekt përfshihej nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet komunave dhe aktorëve të ndryshëm si përgjigje ndaj dhunës në familje në komuna. Prej vitit 2015 është planifikuar një fazë e re tri vjeçare e projektit. Projekti i dytë në të cilin përfshihen aktivitetet për përmirësimin e bashkërendimit komunal, i cili mbështetet nga OSBE, do të funksionojë së pari për një vit prej vitit 2015. Projekti do të zbatohet në Mitrovicë, Pejë, Prishtinë, Prizren dhe Viti dhe do ta përfshijë nënshkrimin e Memorandumeve të Mirëkuptimit lidhur me bashkëpunimin ndërmjet aktorëve të ndryshëm në rajone dhe mbështetjen praktike shtesë për zhvillimin e mekanizmave bashkërendues komunalë për dhunën në familje.

Në përgjithësi, bashkërendimi i brendshëm policor është raportuar si konstruktiv kryesisht për shkak të ekzistimit të njësive të specializuara të dhunës në familje në njësinë e hetimit (n=6). Për shembull, nëse hetuesi kryesor nuk ka qenë në punë kur është raportuar incidenti, ai person do të azhurnohet me tu kthyer në punë dhe më pas do të përfshihet në rast (n=1).

Analiza: Të arriturit e përfundimeve të kujdesshme, duket që PK është në përgjithësi në dijeni lidhur me aktorët e jashtëm me të cilët është e obliguar të bashkërendohet për rastet e dhunës në familje. Megjithatë, është me rëndësi që bashkërendimi në mes të aktorëve të sipërpërmendur të forcohet dhe të standardizohet në mbarë Kosovën. Edhe pse duket që policia dhe prokurorët i ndajnë me dëshirë informatat për incidentet e dhunës në familje, do të ishte e këshillueshme që prokurorët ta informojnë policinë lidhur me rastet në mënyrë që informatat për përparimin në raste të mund të shfrytëzohet për përpjekjet e PK-së në ofrimin e shërbimeve policore në bashkësi. Për më tepër, do të ishte e dobishme që gjithmonë të sigurohet ndarja e vlerësimit të rrezikut të viktimës të kryer nga policia si me prokurorët ashtu edhe me strehimoret. Edhe pse bashkëpunimi me strehimoret është përshkruar si i mirë, strehimoret përballen me probleme dhe vështirësi në ofrimin e shërbimeve të kërkuara të rehabilitimit për viktimat. Kjo është diskutuar më hollësisht në pjesën e përgjigjeve të kontrollit. Prandaj, bashkëpunimi në mesin e aktorëve mund ta arrijë vetëm mbështetjen e viktimave nëse nuk ofrohet mbështetja institucionale nga komunat dhe ministrinë e ndryshme të Kosovës. Në lidhje me veriun e Kosovës, ekzistojnë shumë më pak aktorë të jashtëm për mbështetje lidhur me dhunën në familje dhe prandaj këtyre fushave duhet t'iu kushtohet vëmendje si edhe burime të posaçme.

Këta aktorë (ZANV, strehimorja, qendrat sociale, gjykata, prokurori) punojnë në pjesën jugore për pjesën veriore.

Në fund, siç është përshkruar më herët, dukej që bashkëpunimi i brendshëm policor është efektiv, në veçanti për shkak të njësive të specializuara për hetimin e dhunës në familje në stacion, në nivel rajonal dhe qendror.

Tema 4: Mbledhja e të dhënave

Njësia për dhunën në familje në nivel qendror ishte në gjendje t'i ofrojë EULEX Kosova të dhëna të hollësishme për vitin 2014 nga të gjitha rajonet nga baza e të dhënave e vetë njësisë

(shih Tabelën 2; Vlen të theksohet numri dukshëm më i ulët i incidenteve në Mitrovicë në veri, për shkak të çështjeve që kanë të bëjnë me mos-raportimin potencial të dhe implementimin e SIMPK).

Nëse SIMPK është pjesë e organizatës dhe implementohet plotësisht, ai do të përmirësojë mbledhjen e të dhënave.

Pjesëmarrësit nga dy prej rajoneve të intervistuarra kanë të dhëna për rastet e dhunës në familje për vitin 2013 dhe 2014 të cilat korrespondojnë me të dhënat e nivelit qendror. Megjithatë, stacionet e tjera nuk ishin në gjendje t'ju ofrojnë intervistuesve të dhëna për nivelin rajonal (n=3) ose për nivelin e stacionit (n=2). Sa i përket ndarjes së të dhënave për rastet, një stacion theksoi që ata i raportojnë njësisë rajonale për dhunën në familje lidhur me numrin e rasteve për çdo javë për numrin e viktimave dhe të kryesve të veprës (n=1). Rajoni pastaj raporton në selinë e policisë në Prishtinë, të cilët mbajnë shënime për llojin e shkeljes, kryesit e veprës, viktimat dhe arrestimet (n=2). Nëse një viktimë ose kryes i veprës është nga një rajon tjetër prej atij në të cilin ka ndodhur incidenti, mund të kontaktohen pjesëtarët e personelit nga rajoni tjetër të cilët punojnë në bazën e të dhënave për informata që janë të lidhura me rastet e tjera, nëse është e nevojshme (n=1). Të gjitha dosjet e rasteve të kaluara i bashkëngjiten dosjeve të rastit më të ri për referim në të ardhmen (n=1). Megjithatë, kishte mospajtime nëse informatat për urdhrat e mbrojtjes ishin (n=1) apo nuk ishin (n=1) përfshirë në bazën e të dhënave të stacionit për dhunën në familje.⁵⁸

Tabela 2. Numri i rasteve të dhunës në familje më 2014, sipas rajonit

Rajoni	Numri i rasteve më 2014
---------------	--------------------------------

⁵⁸ Shefit për dhunën në familje i është shtruar pyetja pasuese për ta sqaruar këtë mospërputhje. Edhe pse është thënë që hetuesit e dhunës në familje e regjistrojnë 'shumicën' e Urdhrave për Mbrojtje në stacionet e tyre përkatëse të policisë, ka qenë e pamundur të sqarohet nëse Urdhrat për Mbrojtje janë futur në një bazë të të dhënave apo në SIPK.

Ferizaj	128
Gjilan	166
Mitrovicë Veri	46
Mitrovica e jugut	129
Pejë	232
Prishtinë	268
Prizren	210

Analiza: Edhe pse ka të dhëna të centralizuara për dhunën në familje, duket që do të mund të bëheshin përmirësime që të dhënat të jenë në dispozicion të të gjithë pjesëtarëve të PK-së të cilët merren me rastet. Për shembull, do të ishte e këshillueshme të sigurohet që të dhënat për dhunën në familje përfshihen në bazën e të dhënave të Sistemit të centralizuar të Informacionit të Policisë së Kosovës (SIPK). Qasja në historitë e rasteve lidhur me viktimat dhe kryesit e veprës duhet të jetë e lehtë në mënyrë që të përmirësohen kapacitetet e PK-së për t'u përgjigjur ndaj incidenteve të dhunës në familje. Njësitë patrulluese të PK-së duhet të kenë qasje në informatën për urdhrin për mbrojtje meqë shpesh ata janë të parët që mbërrijnë në skenën e dhunës në familje dhe duhet ta përcaktojnë nëse është shkelur urdhri i mbrojtjes. Për më tepër, përfshirja e informatave të hollësishme dhe të standardizuara lidhur me rastin në raportet për prokurorët dhe aktorët e tjerë do ta përmirësonte aftësinë e të gjithë aktorëve që të përgjigjen në mënyrë efektive ndaj dhunës në familje. Në mënyrë që të përputhen me praktikat e mira ndërkombëtare, të dhënat duhet të jenë elektronike, të qasshme lehtë, të centralizuara dhe të përmbajnë informata të hollësishme lidhur me viktimën dhe kryesin e veprës. Trajnimi për shfrytëzimin efikas dhe adekuat të SIPK do të ishte i dobishëm për ta siguruar zbatimin e tij më efektiv.⁵⁹

Tema 5: Përgjigjet efektive ndaj dhunës në familje

⁵⁹ Analiza është formësuar nga një studim i brendshëm i EULEX Kosova, 'Analizë e mbledhjes së të dhënave për krimet lidhur me dhunën gjinore në institucionet e Kosovës për sundimin e ligjit' prej marsit 2014.

Në pajtim me qëllimin e këtij hulumtimi, nga të intervistuarit është kërkuar ta përshkruajnë ndonjë praktikë brenda stacionit apo rajonit që është në veçanti e dobishme gjatë përgjigjes ndaj dhunës në familje. Është theksuar ekzistimi i njësive dhe i personelit të specializuar për dhunën në familje (n=4). Për shembull, në Gjilan, njësia për dhunën në familje e ka një dhomë të posaçme për intervistimin e viktimave të dhunës në familje e cila është e pajisur me një divan, një shtrat për foshnje dhe lodra/fotografi për fëmijë. Është zbuluar që përdorimi i kësaj dhomë ofron mjedis më të rehatshëm për viktimat dhe fëmijët e tyre deri sa janë në stacion dhe shërben për t'ua hequr vëmendjen fëmijëve deri sa policia bisedon me prindin lidhur me incidentin. Shefi i Departamenti për Hetimin e Dhunës në Familje dhe Delikucencë të të Miturëve në Prishtinë theksoi se të gjitha stacionet nuk i kanë mundësitë e tilla dhe për pasojë intervistat nganjëherë ndërpriten.

Po ashtu është zbuluar si e dobishme edhe futja në përdorim e PSO për dhunën në familje (n=3). PK kanë ndërmarrë projekte të bazuara në bashkësi në Gjilan të cilat janë të jenë efektive për ngritjen e vetëdijes lidhur me temën e dhunës në familje dhe të asaj të bazuar në gjini, duke organizuar biseda në shkolla dhe duke u angazhuar me mediat vendase lidhur me këtë çështje. Pjesëmarrësit po ashtu i kanë përmendur praktikatat e mira në rajonet e tyre të cilat kanë qenë të dobishme për plotësimin e nevojave ekonomike për viktimat e dhunës në familje dhe si të tilla edhe për policinë si kontribuuese për prishjen e ciklit të dhunës që ndodhë në raportet e afërta. Për shembull, në disa rajone, nismat nga bizneset vendase e kanë mbështetur në veçanti punësimin e femrave, të cilat kanë qenë viktimat të dhunës në familje, që prindërshe do të mbeteshin financiarisht të varura nga kryesi i veprës së dhunës (n=2). Siç u tha më herët, pilot projektet për bashkërendim në një numër të rajoneve kanë qenë të dobishme për PK-në (n=4).

Analiza: Kjo pjesë tregon praktikatat dhe mjetet të cilat PK-ja i konsideron si shumë efektive në të ndihmuarit e punës së tyre. Është e këshillueshme që praktikatat efektive të futen në përdorim në të gjitha stacionet anembanë Kosovës. Për shembull, shfrytëzimi i dhomave të specializuara për hetimin e dhunës në familje do ta përmirësonte përgjigjen e PK-së të përqendruar në viktimën dhe do t'i ndihmonte policisë në sigurimin e dëshmisë më të saktë të mundshme të viktimës. Së dyti, shfrytëzimi i PSO për dhunën në familje në Kosovë, që ofron format e nevojshme të zhvillimit të fazave të ndryshme të hetimeve dhe të vlerësimit të viktimave, i ka ofruar PK-së një udhërrëfyes të dobishëm për mënyrën e zbatimit të legjislationit për dhunën në familje në praktikë dhe është dëshmuar të jetë një aset i

dobishëm. Nëse respektohet në të gjitha stacionet e PK-së, përfshirë veriun e Kosovës, PSO do të mund ta përmirësonte edhe më përgjigjen ndaj dhunës në familje. Në fund, pothuajse të gjithë të intervistuarit e kanë shprehur zhgënjimin e tyre lidhur me gjendjen ekonomike si pasojë e së cilës viktimat shpesh kthehet në një lidhje abuzive për shkak të skamjes. Nismat jashtë PK-së të cilat i punësojnë gratë të cilat kanë qenë viktimat të dhunës në familje ju ofrojnë atyre shans më të mirë për jetesë të pavarur dhe të qëndrueshme. Nismat e mëtejme do ta ndihmonin shumë në redukimin dhe parandalimin e dhunës në familje në Kosovë, meqë viktimat mund të jenë në gjendje të dalin nga cikli i dhunës në familje.

Tema 6: Fushat ku mund të bëhet përmirësim

Nga pjesëmarrësit është kërkuar ta përshkruajnë ndonjë fushë të punës së tyre lidhur me rastet e dhunës në familje e cila sipas mendimit të tyre do të mund të përmirësohej në lidhje me rastet e dhunës në familje. Nevoja e cila është përmendur më së shumti nga PK (n=4), si për hetuesit e specializuar ashtu edhe për policët patrullues të cilët zakonisht vijnë në kontakt me incidentet e dhunës në familje. Së dyti, pjesëmarrësit kanë dëshiruar bashkërendim të përmirësuar ndërmjet përgjegjësve të ndryshëm ndaj dhunës në familje (n=3). Një rajon ka propozuar që takimet të cilat do të mbaheshin dy herë në muaj për të gjithë aktorët, përfshirë policinë, prokurorët, OJQ-të dhe kuvendin komunal do të ishin një metodë efektive për zbatimin e kësaj. Siç është përshkruar më herët, pjesëmarrësit u shprehën që shfrytëzimi i dhomave të specializuara për dhunën në familje do ta lehtësonte një përgjigje të përmirësuar ndaj viktimave të dhunës në familje (n=2). Së fundi, pjesëmarrësit bënë thirrje për metoda të përmirësuara të mbledhjes dhe ndarjes së të dhënave (n=2).

Përveç ndryshimeve të dëshiruara brenda PK-së, të intervistuarit shprehën nevojën për një numër të nismave të jashtme për të siguruar daljen e viktimave nga cikli i dhunës. Së pari, ata zbuluan që ende nevojitet përmirësim i vetëdijesimit për dhunën në familje (n=3). U theksua 'Qëndrimi ballkanik' ndaj dhunës kundër grave, përmes së cilit strukturat patriarkale në shoqëri mbesin të fuqishme. Për pasojë, ka më pak të ngjarë që viktimat ta paraqesin abuzimin e tyre dhe ato mendojnë se dhuna e ushtruar ndaj tyre është e arsyeshme (n=2). Një komandant i një stacioni vlerësoi që më shumë se gjysma e incidenteve të dhunës në familje vazhdojnë të mbesin të pa raportuara. Nismat tjera, siç janë fushatat edukative në shkolla, fushatat në mediat sociale ose nismat afariste për punësimin e grave të cilat u përmendën më herët, do të ishin të dobishme për rajonet (n=2). Në fund, një hetues i specializuar për dhunën

në familje dëshiroi të kishte një homolog hetues njësoj të specializuar në kuadër të prokurorisë themelore të Kosovës në rajonin e tyre në mënyrë që të ketë përmirësim të bashkërendimit dhe një qasje të ndjeshme ndaj viktimës dhe gjinisë.

Analiza: Në këtë pjesë theksohen fushat në të cilat policët e intervistuar e shohin mundësinë më të madhe për përmirësim në institucionet e tyre. Sa i përket dëshirës për trajnim, PK tashmë trajnohet për dhunë në familje në një numër të kapaciteteve. Të gjithë policët kryejnë trajnimin themelor për dhunën në familje në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike dhe viteve të fundit organizatat ndërkombëtare siç është OSBE, Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe Gratë e KB (UN Women) kanë ofruar trajnim. Policia mund të përfitojë po ashtu edhe nga kurset përkujtuese për dhunën në familje.⁶⁰ Trajnimi shtesë është gjithmonë i dobishëm dhe duhet të përqendrohet në fushat në të cilat ka më së shumti mundësi për përmirësim. Për shembull, do të ishte i dobishëm trajnimi për mbledhjen e të dhënave, për mënyrën e bashkërendimit më të mirë lidhur me rastet dhe për zbatimin e duhur të ligjit. Për më tepër, trajnimi duhet t’iu ofrohet zyrtarëve policorë të të gjitha gradave për ta siguruar një përgjigje të plotë ndaj dhunës në familje brenda institucionit.

Shtimi i bashkërendimit me homologët e specializuar për përgjigjen ndaj dhunës në familje do të ishte i dobishëm. Ashtu siç dëshironte një pjesëmarrës, brenda prokurorisë themelore të Kosovës janë vendosur prokurorët e specializuar. Megjithatë, siç do të diskutohet edhe në pjesën e përgjigjeve të prokurorëve, niveli i trajnimit dhe mekanizmat e bashkërendimit të cilët i kanë në dispozicion këta aktorë duhet të përmirësohen në mënyrë që të rritet efektiviteti i tyre.

Së fundi, Ministria e punës dhe e mirëqenies sociale, Ministria e shëndetësisë, Ministria e drejtësisë, Ministria e punëve të brendshme, Ministria e kulturës, e rinisë dhe sportit dhe Ministria e arsimit janë ligjërisht përgjegjëse për ofrimin e mbështetjes dhe të infrastrukturës së nevojshme që nevojitet për ‘mbështetjen dhe plotësimin e nevojave të personave ndaj të cilëve ushtrohet dhuna në familje, përfshirë ndihmën sociale dhe shërbimet mjekësore’.⁶¹ Megjithatë, në bazë të përvojave të pjesëmarrësve lidhur me nevojat e viktimave të dhunës në familje është e qartë që ende nevojitet përmirësim i madh në ofrimin e shërbimeve adekuate.

⁶⁰ Intervistat me hetuesit e specializuar të PK-së për dhunën në familje (2015).

⁶¹ Ligji Nr.03/L-182, Neni 27.

Përgjigjet e prokurorëve

Tema 1: Historiku dhe roli i personave kontaktues për dhunën në familje

Të gjithë shtatë (7) prokurorët, persona kontaktues për dhunën në familje, janë duke punuar si prokurorë në kuadër të Departamenteve të Përgjithshme të Prokurorive Themelore të Kosovës. Ata kanë kualifikime të ndryshme, disa kanë punuar si prokurorë, avokatë dhe gjyqtarë para se ta mbanin pozitën e tyre aktuale. Mesatarisht, ata janë emëruar si persona kontaktues për katër muaj (që sillej ndërmjet dy dhe gjashtë muajve). Personat kontaktues nuk kanë marrë ndonjë termë të referencës për detyrat e tyre në këtë pozitë. Një numër i të intervistuarve (n=4) thanë që ekziston një plan që personat kontaktues t'i krijojnë termat e referencës për funksionim efektiv. Megjithatë, nuk mund të përvijohet kurrfarë afati kohor për këtë projekt. Duke e pasur parasysh paqartësinë në këtë aspekt, disa prej personave kontaktues kanë filluar t'i përcaktojnë rolet e tyre në zyrat e tyre. Një person kontaktues ka filluar t'i mbledhë të dhënat për një numër të rasteve të dhunës në familje që ka çuar tek ndjekja penale në rajonin e tyre. Një person tjetër kontaktues ka vendosur kontakt të posaçëm me PK-në në rajonin e tyre, kështu që ata kontaktohen drejtpërdrejt nëse një rast i dhunës së familje përfshin elemente të veprës penale, paraqitet në polici. Disa persona kontaktues (n=3) veprojnë si pikë referuese në rajonet e tyre, nëse prokurorët e caktuar në rastet e dhunës në familje kanë nevojë për këshilla shtesë lidhur me rastet problematike. Megjithatë pjesa më e madhe e personave kontaktues (n=6) nuk i marrin automatikisht rastet e dhunës në familje. Më saktë, prokurorët kujdestarë do t'i marrin këto raste pavarësisht nga përvoja e tyre ose trajnimi për t'u marrë me këto çështje të ndjeshme. Secili prej personave kontaktues për dhunë në familje kanë kryer njëllor trajnimi të organizuar nga organizatat ndërkombëtare, siç është ai për dhunën në familje i organizuar nga Ambasada e SHBA (n=7) ose nga OSBE (n=1), ose trajnimi për qasjen e përqendruar në viktimën i organizuar nga EULEX Kosova (n=1).

Analiza: Nga intervistat ishte e qartë që personat kontaktues për dhunën në familje janë prokurorë të kualifikuar mjaftueshëm brenda Departamenteve të Përgjithshme të Prokurorive Themelore të Kosovës. Megjithatë, ishte po ashtu e qartë që për shkak të mungesës së kushteve të përgjithshme të punës (termave të referencës), pritjet për pozitat e personave të tillë kontaktues janë në përgjithësi të paqarta. Termat e qarta të referencës duhet të hartohen sa më parë që të jetë e mundur në mënyrë që prokurorët e specializuar të mund të bëhen

mekanizëm efektiv për përmirësimin e përgjigjeve ndaj dhunës në familje. Në këtë mënyrë, mund të arrihen sukseset e ngjashme si me njësitë e specializuara brenda PK-së. Siç u përmend, personat kontaktues kanë mbajtur njëlloj trajnimi. Megjithatë, për të qenë efektiv, trajnimi i mëtejshëm mund të jetë i dobishëm.

Tema 2: Procesi i ndjekjes

Personat kontaktues për dhunë në familje e kanë përshkruar mënyrën si i trajtojnë Prokuroritë Themelore veprat penale të kryera si pjesë e dhunës në familje. Të gjitha rastet shqyrtohen në pajtim me KPK dhe atyre ju jepet statusi i përparësisë së lartë (n=7). PK i paraqet rastet në Prokurorinë Themelore duke ua ofruar atyre deklaratën e viktimës dhe ndonjë UM (n=7). Përveç rasteve të kërcënimit, të gjitha aktet e tjera penale të cilat ndodhin në kontekst të dhunës në familje ndiqen penalisht *ex officio*.⁶² Prandaj, kërkesat për heqjen dorë nga rasti pasi që të jetë paraqitur në polici dhe prokurori nuk do të aprovohen (n=6). Në rastet të cilat nuk kanë të bëjnë me vepra penale nuk informohen prokurorët. Në vend të kësaj, rasti shkon drejtpërdrejt në sistemin e drejtësisë civile (n=7). Megjithatë, nëse shkelet UM, prokurorët reagojnë menjëherë sapo të njoftohen nga policia (n=6). Siç është thënë më parë, kryeprokurori në rajon ua cakton rastet penale prokurorëve të cilët janë kujdestarë (n=6). Kur të caktohet rasti nuk merret parasysh as trajnimi as përkatësia gjinore e prokurorit (n=4). Megjithatë, një person kontaktues ka theksuar që me kërkesën e viktimës mund të caktohet një prokuror. Prokurorët mbledhin dëshmi për rastin dhe kur ka dëshmi të mjaftueshme e ngritin aktakuzën (n=7). Është theksuar që në viktimat nuk ushtrohet trysni kurrë për të dhënë dëshmi, për shkak të natyrës së ndjeshme të krimit (n=4).

Analiza: Intervistat kanë treguar që në përgjithësi prokurorët kanë qenë në dijeni për obligimet e tyre lidhur me rastet e dhunës në familje, ashtu siç parashikohet me ligj. Marrëveshjet e fuqishme ndërmjet pjesëmarrësve, ku përgjigjet sillen prej (n=4) në (n=7), tregojnë që praktikat janë relativisht të standardizuara në rajone. Megjithatë, duhet të përmenden disa çështje.

Një person kontaktues i cili u intervistua për këtë studim e përshkroi një situatë në të cilën prokurorët, me kërkesë të viktimës, nuk e ndoqën penalisht një rast. Megjithatë, kur rasti fitoi vëmendjen e publikut, ai u ndoq penalisht brenda afatit kohor. Kjo nënvizon situatën në të

⁶² Penal Nr.04/L-123, Neni 185 (5).

cilën nuk është respektuar si duhet obligimi për ndjekjen *ex officio* të të gjitha krimeve të dhunës në familje. Pjesëmarrësi ka theksuar që një situatë e tillë nuk do të ndodhë më. Kjo duhet të jetë kështu në mënyrë që të vihet në rregull sundimi i ligjit.

Në fund, edhe pse personat kontaktues për dhunën në familje nuk merreshin vetëm me rastet e dhunës në familje, duhet bërë përpjekje në mënyrë që rastet e dhunës në familje t'ju caktohen atyre që e kanë kryer trajnimin. Nëse rasti i dhunës në familje i caktohet një personi jo-kontaktues, mund të vendoset një praktikë e mirë që të sigurohet përfshirja e personit kontaktues në cilësinë e monitorimit dhe të ëshillimit për rastin.

Tema 3: Bashkërendimi

Një temë e rëndësishme që doli në pah gjatë intervistave ishte ajo e bashkërendimit për rastet e dhunës në familje, si brenda Prokurorive Themelore ashtu edhe ndërmjet Prokurorive Themelore dhe aktorëve të tjerë.

Të gjithë personat kontaktues u shprehën që nuk kanë kontakt me personat tjerë kontaktues për dhunën në familje në Kosovë, përveç kur janë takuar në trajnimin fillestar për dhunën në familje (n=7) ose si pjesë e Forumit të gjyqtareve dhe të prokuroreve të Kosovës (n=3). Për më tepër, nuk ka takime të rregullta me prokurorët brenda rajoneve të ndryshme për t'i diskutuar përgjigjet më të mira ndaj krimeve të dhunës në familje. Megjithatë, tre (3) nga personat kontaktues femra, të cilat theksuan që janë pjesë e Forumit të gjyqtareve dhe të prokuroreve të Kosovës, i përvijuan planet e tyre për hartimin e doracakut ligjor për përgjigjet ndaj dhunës në familje nga fushat e tyre gjatë muajve në vijim.

Në lidhje me bashkërendimin e jashtëm, prokurorët u shprehën se kanë bashkërendim të mirë me PK-në (n=7), avokatët e viktimave (n=4) dhe me gjyqtarët civilë (n=2). Avokatët e viktimave janë posaçërisht të rëndësishëm për prokurorët për shkak të rolit të tyre në mbështetjen e viktimës gjatë tërë procesit të drejtësisë (n=4). Pjesëmarrësit nga katër rajonet, të cilët kanë qenë pjesë e aktiviteteve komunale të bashkërendimit të mbështetur ose nga UN Women ose nga OSBE-ja, theksuan që do të donin të luanin rol në këta mekanizma dhe ta përmirësojnë bashkërendimin me aktorët e tjerë.

Analiza: Është e qartë që në lidhje me rastet e dhunës në familje duhet të përmirësohet bashkërendimi i brendshëm. Pas vendosjes së personave kontaktues për dhunë në familje, tani

ka mundësi të krijohen një rrjet efektiv i bashkërendimit për t'i diskutuar praktikat më të mira dhe mundësinë e pengesave për t'u përgjigjur lidhur me rastet. Për t'i diskutuar këto çështje do të mund të mbaheshin takime një herë apo dy herë në muaj. Përpyekjet premtuese për bashkërendim përfshijnë hartimin e një doracaku ligjor për dhunën në familje nga ana e Forumit të gjyqtareve dhe të prokuroreve të Kosovës dhe planet e personave kontaktues për hartimin e termave të referencës gjatë muajve në vijim. Doracakë mbështetës duhet të hartohen sa më parë që të jetë e mundur për t'i përmirësuar përgjigjet për viktimat e dhunës në familje.

Gjatë fazave të ndryshme të një rasti të dhunës në familje, prokurorët bien në kontakt me aktorët e tjerë siç është PK-ja dhe avokatët e viktimave. Megjithatë, përveç bashkërendimit për obligimin e ndarjes së informatave lidhur me rastin, takimet e rregullta bashkërenduese do të ishin të dobishme për përcaktimin e praktikave të mira dhe tejkalimin e rasteve të vështira.

Tema 4: Mbledhja e të dhënave

Tre (3) prej personave kontaktues thanë që ata nuk kanë të dhëna për viktimën e dhunës në familje apo të dhëna rajonale për këtë dhe tre (3) të tjerë theksuan me pasiguri që të dhënat për dhunën në familje i mbledhë “dikush tjetër”. Për qëllim të intervistës, një person kontaktues i siguroi të dhënat për krimet e dhunës në familje nga PK-ja. Duket që është praktikë e zakonshme që prokurorët individualë, të cilët i marrin përsipër rastet e dhunës në familje, t'i mbajnë të dhënat për këto raste. Duket që në Prokuroritë Themelore nuk ka të sistem të centralizuar të të dhënave për krimet e kryera në kontekst të dhunës në familje (n=4). Megjithatë, është raportuar që në Prishtinë ekziston një sistem i centralizuar në të cilin gjenden informatat lidhur me numrin e viktimave të dhunës në familje dhe të kryesve të asaj dhune (n=1). Është theksuar që gjykatat e posedojnë një bazë të të dhënave me informata për dhunën në familje dhe se kjo bazë e të dhënave shfrytëzohet nga prokurorët për ta përcaktuar nëse kryesi i veprës është kundërvajtës recidiv (n=2). Në përgjithësi personat kontaktues ishin të mendimit se më shumë raste po raportohen (n=4).

Analiza: Ishte vështirë të merren të dhëna nga Prokuroritë Themelore lidhur me numrin e incidenteve që kishin të bënin me dhunën në familje të cilat kishin ndodhur në secilin rajon në vitet e mëparshme. Vetë prokurorët u shprehën se është vështirë për ta të sigurojnë të dhënat sepse ato nuk janë të centralizuara. Mbledhja e të dhënave dhe ndarja e informatave

është çështje e ngutshme dhe duhet të përmirësohet me një bazë elektronike të të dhënave, e cila ka shumë nivele të informatave nga përgjegjës të shumtë, për t'i siguruar përgjigjet më të mira.⁶³ Të pasurit e informatave të hollësishme lidhur me historitë e rasteve dhe ndarja e të dhënave do t'ua mundësonte prokurorëve ta përmirësojnë përgjigjen e tyre ndaj dhunës në familje duke pasur një pamje të tërësishme të rastit me të cilin merren.

Tema 5: Përgjigjet efektive ndaj dhunës në familje

Kur është kërkuar që t'i theksojnë fushat në të cilat përgjigjet ndaj dhunës në familje janë të mira, rezultatet ishin të ndryshme dhe shpesh përqendroheshin jashtë detyrave të vetë prokurorëve. Dy (2) persona kontaktues thanë që urdhrat për mbrojtje janë një metodë efektive për t'i bindur kryesit e veprës të mos ushtrojnë më dhunë në të ardhmen. Paraburgimi po ashtu u përmend si i dobishëm për "t'ua hapur sytë kryesve të veprës" lidhur me seriozitetin e veprimeve të tyre (n=2). Dy prokurorë shprehën kënaqësinë e tyre lidhur me Kodin e ri Penal të Kosovës meqë të gjitha krimet e kryera në kontekst të dhunës në familje, me përjashtim të kërcënimit, ndiqen penalisht *ex officio*. U theksua që krijimi i Forumit të gjyqtareve dhe të prokuroreve të Kosovës është shumë i dobishëm meqë mundëson diskutimin e praktikave më të mira për tema të ndryshme, përfshirë dhunën në familje (n=2). U theksua edhe një herë bashkëpunimi i mirë ndërmjet policisë dhe prokurorëve (n=4) dhe u sugjerua që rritja e numrit të viktimave që po paraqiten tek autoritetet është dëshmi për përmirësimin e përgjigjes ndaj rasteve të dhunës në familje (n=3).

Analiza: Siç u theksua, përgjigjet e prokurorëve lidhur me praktikën e mira nuk janë përqendruar në praktikën e mira të brendshme brenda Prokurorisë Themelore të Kosovës. Prandaj, është e mundur të sugjerohet që pjesëmarrësit nuk ishin në gjendje t'i identifikonin fushat në të cilat përgjigjet e tyre mund të jenë veçanërisht të dobishme për viktimat e dhunës në familje. Trajnimi i mëtejshëm për përgjigjen ndaj dhunës në familje dhe viktimave të cenueshme mund t'ua mundësojë prokurorëve përcaktimin e hapave të parë për praktikë të mirë në të ardhmen.

⁶³ Siç është përvijuar në studimin e brendshëm të EULEX Kosova, 'Analiza e mbledhjes së të dhënave për krimet që kanë të bëjnë me dhunën gjinore në institucionet e sundimit të ligjit në Kosovë' nga marsi 2014.

Tema 6: Fushat e përmirësimit

Nga personat kontaktues u kërkuar po ashtu ta diskutojnë ndonjë fushë të ndjekjes në të cilën ata mendojnë se mund të bëhet ndryshim pozitiv. Të gjithë personat kontaktues për dhunën në familje dëshironin terma të referencës për rolin e tyre. Pjesa më e madhe e personave kontaktues shprehën dëshirën për emërimin e një prokurori të specializuar me udhëzime dhe trajnim adekuat dhe që punon kryesisht në rastet që kanë të bëjnë me dhunën në familje (n=6). Është kërkuar po ashtu një njësi e specializuar për dhunën në familje, ngjashëm me atë brenda PK-së apo njësisë së krimit të organizuar në sektorin e prokurorisë (n=3). Në mungesë të ndryshimeve të tilla, është kërkuar që personat kontaktues të kryejnë trajnim shtesë (n=4) dhe që ata do të dëshironin të kishin takime ku do të mund të diskutoheshin praktikat e mira dhe fushat për përmirësim (n=3). U ngritën po ashtu shumë çështje të përgjithshme, siç është mungesa e përgjithshme e prokurorëve. Personat kontaktues folën për numrin e madh të lëndëve dhe mospërputhjen e numrit të stafit me ngarkesën e punës (n=3). Për shembull në një rajon janë vetëm pesë prokurorë.

Prokurorët po ashtu thanë që përkundër përgjigjes së mirë të Prokurorive Themelore dhe PK-së, cikli i dhunës në familje do të vazhdojë përveç nëse përmirësohet mundësia e sigurimit të institucioneve për rehabilitim dhe ri-integrim (n=6). Në këtë aspekt u theksuan strehimoret meqë në Kosovë ka mungesë të madhe të tyre dhe ato që ekzistojnë janë të mbingarkuara dhe nuk financohen sa duhet (n=5). U theksua edhe një numër i kërkesave të tjera, përfshirë krijimin e dhomave të specializuara për hetime në të gjitha rajonet që të plotësojnë nevojat e fëmijëve të cilët kanë qenë dëshmitarë të dhunës në familje apo e kanë përjetuar atë dhe ta parandalojnë traumatizimin e serishëm gjatë procesit të intervistës (n=2). Po ashtu u kërkuar edhe mbështetje tjetër psiko-sociale për fëmijët (n=2). U theksua që ende duhet të rritet vetëdijesimi lidhur me dhunën në familje, në veçanti në vendet rurale, meqë autoriteteve të Kosovës ju raportohen vetëm disa prej shumë incidenteve aktuale të dhunës në familje (n=2). Përmirësimi i mundësive ekonomike për gratë do ta ndihmonte thyerjen e ciklit të dhunës dhe varësinë ekonomike (n=3).

Në fund, gjatë intervistave në pah dolën dy deklaratatë të habitshme. Së pari, njëri nga prokurorët shprehu dëshirën që të mund të hiqej dorë nga rasti nëse viktimat e dëshirojnë këtë. Kjo nënvizoi që prokurori nuk e kuptonte rëndësinë e ndjekjes *ex officio dhe nevojën për* trajnim në kuadër të Prokurorive Themelore lidhur me hollësitë e marrëdhënieve abuzive familjare. Për më tepër, u paraqit kërkesa për vendosjen e një koordinatori për dhunë në

familje për mbarë Kosovën, një pozitë që tashmë është krijuar. Kjo çon tek mungesa e rëndë e bashkërendimit të përgjithshëm për dhunën në familje dhe prandaj duhet të bëhen përpjekje për ta siguruar përfshirjen aktive të prokurorëve në mekanizmin e bashkërendimit nacional.

Analiza: Në përgjithësi, duket që mekanizmit të personave kontaktues për dhunë në familje në kuadër të Prokurorive Themelore duhet t'i kushtohet vëmendje e shtuar për të siguruar që personave kontaktues ju caktohen role dhe përgjegjësi të qarta dhe ju ofrohet trajnim i përshtatshëm për kryerjen e detyrave të tyre. Për më tepër, shumë (n=6) nga personat kontaktues kërkuan që personi kontaktues të merret me *të gjitha* rastet që kanë të bëjnë me dhunën në familje të cilat policia i sjell në prokurori. Kjo do t'ua mundësonte atyre zhvillimin e një përgjigjeje shumë të specializuar dhe të siguruarit që rastet e viktimave i caktohen një prokurori që ka trajnim të përshtatshëm.

Mëshitetja shtesë nga ministrinë e Kosovës është e nevojshme për të ofruar shërbime të rehabilitimit për viktimat e dhunës në familje dhe në veçanti për fëmijët nga shtëpitë abuzive.

Në fund, është thelbësore që rastet e dhunës në familje me elemente të veprës penale të ndiqen me përpikëri dhe *ex officio*. Ndjeka penale *Ex Officio* ka për qëllim ta neutralizojë mundësinë që viktimat të heqin dorë nga rasti i tyre për shkak të mungesës së informatave për kornizën ligjore ose për shkak të trysnisë nga ushtruesi i dhunës. Është me rëndësi që kryesit të mos mbesin të pandëshkuar dhe që viktimat t'i mos nënshtrohen abuzimit të mëtejshëm për shkak të mos veprimit nga ana e autoriteteve. Përgjigja e përpiktë e institucioneve të sundimit të ligjit mund të ndihmojë në sigurimin që kryesit e veprës së dhunës në familje të mbahen përgjegjës për krimet e tyre.⁶⁴

⁶⁴ Në: Kombet e Bashkuara. (2010). *Handbook for Legislation on Violence Against Women*. United Nations Publications, f.37; Po ashtu, në rastin *Opuz v Turkey*, është zbuluar që autoritetet e ndjekjes duhet të vazhdojnë me krimet e rënda penale, përfshirë në kontekst të dhunës në familje. Kërkesa nr. 33401/02. [Aktgjykimi] 9 shtator 2009, paragrafi 127.

PËRGJIGJET E KONTROLLIT

Në pjesët në vijim gjenden informata e mbledhura nga intervistat me udhëheqësin e zyrës për mbrojtje dhe ndihmë viktimave (ZMNV), me drejtonin e strehimores për gra në Kosovë dhe me një gjyqtar civil në kuadër të Gjykatës Themelore. Edhe pse të pakta në numër, këto intervista janë menduar si mjet i krahasimit me përgjigjet e PK-së dhe të Prokurorive Themelore. Është paraqitur në një historik i shkurtër për punën e secilit shërbim, i pasuar nga kontributet për këtë temë të përgjigjeve të PK-së dhe të Prokurorive Themelore të Kosovës ndaj dhunës në familje.

Zyra për mbrojtje dhe ndihmë viktimave

ZMNV, në kuadër të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, përbëhet nga shtatë (7) ZMNV rajonale në Ferizaj, Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prishtinë dhe Prizren. Me kërkesën e viktimës, avokatët e viktimës ofrojnë ndihmë dhe mbrojtje gjatë tërë procesit të drejtësisë dhe mund ta përfaqësojnë viktimën në gjykatë. Më 2013 Këshillit Prokurorial i Kosovës aprovoi *Rregulloren për mandatin, strukturën dhe funksionimin e Zyrës për mbrojtje dhe ndihmë viktimave*, duke e përvijuar strukturën dhe rolet e ZMNV dhe duke theksuar që avokatët e viktimave duhet të funksionojnë në pajtueshmëri me *Procedurat Standarde të Operimit për mbrojtjen nga dhuna në familje në Kosovë*. Avokatët e viktimave ofrojnë ndihmë për kategoritë specifike të viktimave, siç janë ato që e kanë përjetuar dhunën në familje. Aktualisht në Kosovë janë tetëmbëdhjetë (18) avokatë të viktimave, gjatës (6) prej të cilëve janë avokatë të lartë të cilët e kryejnë po ashtu edhe rolin e bashkërendimit.

Në përgjithësi, udhëheqësi i ZMNV ka qenë i kënaqur me bashkëpunimin ndërmjet PK-së dhe avokatëve të viktimave. Institucionet bashkëpunojnë shpesh lidhur me incidentet e dhunës në familje. Për më tepër, udhëheqësi i ZMNV është i përfshirë rregullisht në trajnimin e PK-së për dhunën në familje i cili mbahet në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike në Vushtrri. Megjithatë, është theksuar që do të mund të bëheshin përmirësime në njëtrajshmërinë e përgjigjes së policisë ndaj dhunës në familje. Është theksuar rëndësia e pajtueshmërisë të saktë me legjislacionin e Kosovës dhe me PSO nga secili polic.

Udhëheqësi i ZMNV është i kënaqur me bashkëpunimin ndërmjet avokatëve të viktimave dhe Prokurorive Themelore të Kosovës. Meqë të dyja bëjnë pjesë në kuadër të strukturës së Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, ato kanë raporte të afërta pune gjatë tërë procedurës së një rasti të dhunës në familje. Është theksuar që personat e sapo vendosur kontaktues për dhunën në familje në kuadër të Departamenteve të Përgjithshme të Prokurorive Themelore të Kosovës do të mund t’iu ndihmonin shumë viktimave të dhunës në familje dhe ta mbështesnin punën e avokatëve të viktimave. Me trajnim të përshtatshëm dhe udhëzime për funksionet e tyre të pritura, personat kontaktues do të mund të ofronin përgjigje të specializuara ndaj dhunës në familje.

Në fund, udhëheqësi i ZMNV i përshkroi praktikat e mira në përgjigje ndaj dhunës në familje në Kosovë dhe t’i përvijojë fushat e përgjigjes të cilat do të përfitonin nga ndryshimi. U theksua si e dobishme mbajtja e shënimeve nga avokatët e viktimave për UM-të që nxirren nga gjykatat. Pastaj, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve para skadimit të urdhrit, avokatët e viktimave e kontaktojnë viktimën për ta përcaktuar nëse ka nevojë për ndihmë në bërjen e kërkesës për zgjatje të UM. Ky shërben si mekanizëm i sigurisë për të siguruar që viktimat mund ta shfrytëzojnë mbrojtjen e cila ju nevojitet nga autoritetet. Megjithatë, janë përvijuar dy fushat kryesore të përgjigjeve të institucioneve të Kosovës ndaj dhunës në familje të cilat duhet të përmirësohen. Së pari, kompensimi për viktimat është problem i madh. Viktimat të cilat janë të varura ekonomikisht nga abuzuesi i tyre kanë nevojë për ndihmë financiare në mënyrë që të largohen nga raporti i dhunshëm. Udhëheqësi i ZMNV ka marrë pjesë në hartimin e ligjit të ri për kompensimin e viktimave dhe vlerëson që ky ligj do të hyjë në fuqi para fundit të vitit 2015, dhe ndryshimet e bëra nga ku ligj do t’i përmirësonin gjasat që viktimat e dhunës në familje të jenë në gjendje të ri-integrohen në shoqëri në mënyrë të suksesshme dhe të bëhen financiarisht të pavarura. Së dyti, u theksua që do të mund të përmirësohej bashkërendimi i përgjithshëm ndërmjet aktorëve të ndryshëm në përgjigjen ndaj dhunës në familje, përfshirë sundimin e ligjit dhe ofruesit e shërbimeve të rehabilitimit. Në veçanti, u theksua që koordinatori i sapoemëruar nacional për dhunën në familje duhet të fillojë sa më parë që të jetë e mundur të angazhohet në mënyrë aktive në rolin e tij.

Strehimorja e grave

Në Kosovë janë gjashtë (6) strehimore të cilat i plotësojnë nevojat për gratë të cilat janë viktima të dhunës në familje. Në strehimoren në të cilën është mbajtur intervista, viktimat e dhunës në familje dhe të trafikimit me qenie njerëzore, të cilat janë pak të rrezikuara, mund të qëndrojnë gjashtë (6) muaj. Megjithatë, në disa raste të rënda, gratë kanë qëndruar deri në tri (3) vjet. Në strehimore mund të vendosen pesëmbëdhjetë (15) viktima në çdo kohë. Edhe pse është zhvilluar një dialog me komunën për rritjen e kapacitetit të strehimores për tridhjetë (30) persona, personeli i strehimores mendon që kjo nuk gjasa të ndodhë për shkak të mungesës së financimit. Kur një viktimë arrin në strehimore, asaj i sigurohet një periudhë pushimi prej dyzet e tetë (48) orëve. Pastaj strehimorja e merr deklaratën dhe nëse viktima dëshiron ofrohen shërbimet psikologjike dhe sociale. Dosja e lëndës së viktimës pastaj dërgohet në qendrën për punë sociale.

Strehimorja përshkroi që PK ka përgjigje shumë të specializuar ndaj dhunës në familje. Ata e përshkruan bashkëpunimin e shkëlqyeshëm ndërmjet strehimores dhe policisë dhe raportuan që PK përgjigjet sakaq kur kërkohen masat për mbrojtjen e viktimës. Për më tepër, strehimorja merr vlerësimin e rrezikut nga policia për secilën viktimë. Strehimorja ka shprehur dëshirën për një prokuror të trajnuar si duhet për dhunë në familje. Po ashtu u theksua që në proceset e hetimit të prokurorëve do të mund të bëheshin përmirësime duke përfshirë në raportet e tyre informata të mjaftueshme lidhur me gjendjen mjekësore dhe psikologjike të viktimave. Meqë strehimoret kanë shumë informata në këtë aspekt, kërkohet bashkëpunim më i madh me Prokuroritë Themelore të Kosovës.

Drejtori i strehimores po ashtu përshkroi një numër të fushave në të cilat mund të përmirësohet përgjigja ndaj dhunës në familje në Kosovë. Për fillim, është emëruar koordinatori i ri nacional dhe ky person duhet të organizojë takime me aktorët e ndryshëm, të mbledhë të dhëna statistikore lidhur me dhunën në familje dhe ta përgatitë Strategjinë nacionale për dhunën në familje. Për më tepër, është thënë që koordinatorët e ardhshëm nacionalë duhet të zgjedhen nga pozita alternative ose të pavarura, meqë zëvendësministri i drejtësisë ka angazhime shtesë që do të mund të ndikonin në dhënien përparësi bashkërendimit për dhunën në familje. Në fund, drejtori i strehimores u shpreh që rrallë ndodhë që gjykatat t'iu japin viktimave të dhunës në familje alimentacion. Kjo i pengon shumë viktima që të jenë të pavarura nga dhuna e kryesit të veprës në të cilin ka mundësi që ato të mbështeten për mbështetje financiare. Prandaj, gjykatat duhet të sigurojnë që viktimave

të dhunës në familje ju ofrohen mbështetje na kryesi i veprës, ashtu siç parashikohet me legjislacionin e Kosovës. Për më tepër, drejtori i strehimores ka theksuar që ministritë e Kosovës duhet të ndajnë mbështetje të shtuar financiare për viktimat e dhunës në familje. Një metodë për këtë do të ishte përmes rritjes së mbështetjes financiare për strehimoret në mënyrë që ato të mund të ofrojnë shërbime thelbësore siç është ushqimi dhe barërat për viktimat. Në fund, nuk ka shërbime rehabilituese për kryesit e dhunës në familje, përkundër faktit që me legjislacion parashikohet kjo.⁶⁵ Prandaj, për t'u marrë me dhunën në familje nevojitet shumë një qasje 'mbarë familjare'.

Gjyqtari civil në kuadër të Gjykatës Themelore

Gjyqtari civil në kuadër të Gjykatës Themelore i intervistuar për këtë studim punon kryesisht me rastet e dhunës në familje duke lëshuar UM dhe UME dhe me rastet e të drejtës familjare. Pas vlerësimit të një rasti dhe dhënies së UM apo UME, gjykata ua dërgon nga një kopje të urdhrin viktimës, të dyshuarit, në rezidencën e të dyshuarit, PK-së, ZMNV, Ministrisë së punës dhe mirëqenies sociale dhe Ministrisë së shëndetësisë.

Gjyqtari u shpreh që PK dhe Prokuroritë Themelore të Kosovës kanë përgjigje të mirë ndaj dhunës në familje, por gjyqtari do që të informohet në rastet e shkeljes së UM. Informata lidhur me këtë do t'ia mundësonte gjyqtarit marrjen e vendimeve më të informuara të gjyqit. U theksua që me bashkërendimin e mjaftueshëm ndërmjet aktorëve UM-të do të mund të ishin një masë efektive për sigurimin e mbrojtjes së një viktime.

Po ashtu u përmendën edhe vështirësitë brenda sistemit gjyqësor. Në radhë të parë, gjyqtari civil nuk merr informata kthyesë nëse njëkohësisht zhvillohet procedura civile dhe ajo penale që kanë të bëjnë me viktimën dhe kryesin e njëjtë të supozuar të veprës. Kjo informatë ndahet vetëm me nismën e vetë gjyqtari, dhe në disa raste gjyqtari mund të mos e ketë pikëpamjen e plotë lidhur me rastin. Gjyqtari po ashtu u shpreh që kur lëshohen UM-të për incidentet e dhunës në familje mund të paraqiten vështirësi. Për shembull, u përshkrua një rast in të cilin gjyqtari vendosi të lëshojë UM për një viktimë dhe kryesin e supozuar të veprës me anë të të cilit hapësira e jetesës në shtëpi ishte ndarë ndërmjet dy personave. Meqë të dy vazhduan të jetonin në shtëpinë e njëjtë, PK-ja e kishte të vështirë ta monitoronte gjendjen dhe të ofronte

⁶⁵ Për shembull: Ministria e shëndetësisë. *Udhëzimi Administrativ Nr.02/2013 mbi metodën e trajtimit të kryesve të dhunës në familje të cilëve ju është shqiptuar masa për trajtim të obligueshëm mjekësor nga alkoolizmi dhe varësia nga substancat psikotropike.*

mbrojtje për viktimën. Megjithatë, gjyqtari nuk mendonte se ishte e mundur ndonjë alternativë tjetër për shkak të mungesës të mbështetjeve të tjera financiare për viktimën. Prandaj, është e qartë që mungesa e mbështetjes për viktimën e bën të vështirë punën e shumicës së institucioneve përgjegjëse për dhunën në familje. Gjyqtari theksoi që një numër i faktorëve ndikojnë në gjendjen aktuale të përgjigjes ndaj dhunës në familje përfshirë mungesën e vetëdijesimit dhe vullnetin politik për këtë çështje, si edhe traditën dhe kulturën në Kosovë.

RASTI 'X'

Rasti 'X' përbëhet nga një varg i incidenteve të jetës reale që ka ndodhur në kontekst të një marrëdhënieje të pohuar abuzive familjare në Kosovë dhe si rezultat i saj institucionet e sundimit të ligjit ishin përgjigjur. Ndërmjet vitit 2013 dhe 2015, i dyshuari gjoja kreu krime, përfshirë lëndim të lehtë trupor dhe kërcënim, ndaj gruas së tij dhe anëtarëve të tjerë të familjes. Ai po ashtu u akuzua për shkelje të UM. *Figura 4* (shih faqe 57) ofron afatin kohor të rendit të incidenteve dhe të përgjigjeve lidhur me to. Për ta siguruar anonimitetin e viktimës dhe të aktorëve të tjerë të përfshirë nuk janë paraqitur emrat dhe vendndodhjet. Paragrafët në vijim e bëjnë një vlerësim të përgjigjeve të institucioneve të sundimit të ligjit lidhur me këtë varg të incidenteve dhe ofrojnë disa shembuj për mënyrën si do të mund të përmirësoheshin përgjigjet. Edhe pse ky raport përqendrohet në PK dhe në Prokuroritë Themelore të Kosovës, për ta paraqitur një pasqyrë të përgjithshme të procedurave gjyqësore janë përfshirë një numër i përgjigjeve të gjykatës dhe të ZMNV.

1. Më 23 shtator 2013 viktima e ka raportuar një sulm nga bashkëshorti i saj, që gjoja i ka shkaktuar lëndim të lehtë trupor. Megjithatë, PK nuk ka paraqitur raport penal në Prokurorinë Themelore deri më 4 tetor 2013. Sipas KPPK,⁶⁶ 'Pas pranimit të dyshimit të arsyeshëm nga ana e policisë që është kryer një vepër penale e ndjekur sipas detyrës zyrtare, policia e ka për detyrë t'ia paraqes prokurorit kompetent të shtetit një raport të policisë brenda njëzet e katër (24) orëve ...'. Prandaj, në këtë rast PK nuk ka vepruar në pajtueshmëri me KPPK dhe nuk i ka ofruar viktimës përgjigje të menjëhershme për ta garantuar sigurinë e saj.
2. Më 2 tetor 2013 është lëshuar një UM për ta siguruar mirëqenien e viktimës pas incidentit të dhunës në familje më 23 shtator 2013. Në lidhje me një incident tjetër që ndodhi më 8 maj 2014, gjyqtari civil në kuadër të Gjykatës Themelore e lëshoi një UM më 14 maj 2014. Në mesin e ndalesave të tjera, urdhri i mëparshëm ia ndalonte kryesit të supozuar të veprës t'iu afrohej palëve të mbrojtura apo shtëpisë në të cilën jetojnë ata aktualisht në distancë prej njëqind (100) metrave. Ky i fundit, në mesin e ndalesave të tjera, ia

⁶⁶ Neni.70 (4).

revokonte përkohësisht të drejtat prindërore. Megjithatë, asnjëri prej UM-ve nuk ia shqiptonte kryesit të pretenduar të veprës masën ‘e pagesës së qirasë për shtëpinë në të cilën jetonte përkohësisht pala e mbrojtur apo të paguante alimentacion për palën e mbrojtur dhe fëmijët’.⁶⁷ Po të kërkohej sipas mënyrës së përshtatshme për procedurën civile, kjo masë do ta ndihmonte shumë mbështetjen e viktimës dhe të fëmijëve të saj për t’i ikur dhunës së mëtejshme.

3. Më 15 gusht 2014, i dyshuari gjoja sulmoi viktimën në një vend publik.⁶⁸ Megjithatë, PK-ja kur nuk dërgoi raport penal në Prokurorinë Themelore lidhur me këtë incident. Viktimës iu desh ta raportonte incidentin drejtpërdrejt në Prokurorinë Themelore, e cila pastaj kërkoi raport penal nga PK-ja. Edhe një herë, kjo tregon dështimin e PK-së në përmbushjen e përgjegjësive të tyre sipas nenit 70 të KPPK dhe përgjigjen me përpikëri ndaj veprave penale. Kjo po ashtu vë në pikëpyetje rolin e ZMNV në lidhje me mbështetjen që është ofruar kur viktima është dashur të shkoj drejtpërdrejt në Prokurorinë Themelore. Për më tepër, deri më tani nuk është ngritur asnjë aktakuzë në lidhje me këtë incident, duke e pasqyruar përgjigjen jo në kohë të Prokurorisë Themelore.
4. Më 29 dhjetor 2014, në Gjykatën Themelore u mbajt seanca e parë gjyqësore e shqyrtimit kryesor për aktakuzën e ngritur më 30 maj 2014.⁶⁹ Megjithatë, sipas KPPK-së,⁷⁰ ‘gjyqtari i vetëm i lëndës apo kryetari i trupit gjykues e caktojnë seancën e parë që të mbahet brenda tridhjetë (30) ditëve prej ngritjes së aktakuzave.’ Kështu, gjyqtari i lëndës nuk ka vepruar në pajtueshmëri me KPPK-në lidhur me këtë çështje dhe është dashur ta caktojë seancën dëgjimore me kohë. Është me rëndësi të theksohet që mos mbajtja me kohë e shqyrtimit të lëndëve është e zakonshme për të gjitha lëndët në Kosovë aktualisht. Megjithatë, edhe pse shqyrtimi i ardhshëm i lëndës do të mbahet në maj 2015, nuk është nxjerrë asnjë aktgjykim lidhur me ndonjërin prej incidenteve penale të pretenduara që kanë ndodhur prej 23 shtatorit 2013. Vonesat e tilla mund të kenë pasoja kërcënuese për viktimat e dhunës në familje për shkak të përsëritjes së shpeshtë të llojit të krimeve të

⁶⁷ Kryesi i dhunës në familje ka për obligim t’i mbështesë këta aktorë, ashtu siç saktësohet në *Ligjin për mbrojtje kundër dhunës në familje*, Neni.11 (1.2).

⁶⁸ Edhe pse në kohën e sulmit të pretenduar ekzistonte një UM, ende nuk është marrë asnjë veprim lidhur me këtë shkelje.

⁶⁹ Aktakuza ishte në lidhje me lëndimin e supozuar të lehtë trupor që ishte paraqitur më 23 shtator 2013.

⁷⁰ Neni 242 (4).

lidhura me të. Prandaj, duhet të bëhen të gjitha përpjekjet që rastet e dhunës në familje të trajtohen në mënyrë efikase.

5. Avokatët e viktimave të përfshirë në rast raportojnë që janë të përgatitur ta kërkojnë vazhdimin e UM që është kërkuar më 14 maj 2014. Sipas nenit 20 të *Ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje*, përfaqësuesit ligjorë të viktimës mund ta dorëzojnë një petition për vazhdimin e UM brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve prej skadimit të urdhrin të vjetër. Kështu që, në këtë rast, avokatët e viktimës janë duke siguruar në mënyrë proaktive që viktima do ta mbajë masën e saj të mbrojtjes sipas të drejtës civile të bazuar në vlerësimin e nevojave.⁷¹
6. Këtë rast e karakterizojnë disa krime megjithatë, në EULEX Kosova është raportuar që PK-ja nuk i ka lidhur menjëherë incidentet e ndryshme si seri. Kjo ka ndodhur vetëm kur personeli ka vërejtur që shumë incidente të dhunës në familje në rajon përfshinin aktorët e njëjtë. Është me rëndësi që seritë e krimin të identifikohen në mënyrë efikase në mënyrë që të parandalohet përshkallëzimi i dhunës. Një sistem informativ plotësisht funksional i Policisë së Kosovës, i cili mund t'ia bëjë seritë e krimeve me dije PK-së, do të mund ta lehtësonte përmirësimin e përgjigjes ndaj rasteve të përsëritura të dhunës në familje.


Përfundimi i rastit

Rasti 'X' ofron një shembull të dhunës në familje nga jeta reale dhe mund të shfrytëzohet si krahasim për informatat e mbledhura nga pjesëmarrësit në këtë studim. Viktima në këtë rast ka përjetuar dhunë në familje me vite të tëra dhe nuk mendon që ka pasur mundësi ta shfrytëzojë drejtësinë apo mbrojtjen e duhur. Ende nuk është ngritur aktakuza për sulmin e pretenduar më 15 gusht 2014. Viktimat mbështetet vetëm në masën civile për mbrojtje, masë e cila është shkelur nga kryesi i veprës në të kaluarën. Seanca e ardhshme dëgjimore për këtë rast do të mbahet në maj 2015, kështu që të gjithë aktorët e përfshirë duhet ta zbatojnë një përgjigje efektive për ta garantuar sigurinë e viktimës dhe qasjen në drejtësi. Natyrisht që ky rast nuk i përfshin të gjitha rastet e dhunës në familje në Kosovë. Bazuar në intervistat me PK-në dhe me Prokuroritë Themelore të Kosovës, këto institucione janë në dijeni lidhur me

⁷¹ Është me rëndësi të theksohet se, edhe pse kanë kaluar dymbëdhjetë (12) muaj prej kërkesës për urdhrin të mbrojtjes më 14 maj 2014, burimet e EULEX Kosova raportojnë që UM është ende në fuqi. Megjithatë, deri më tani nuk është dorëzuar asnjë kërkesë për vazhdimin e UM.

shumicën e përgjigjeve të duhura ndaj dhunës në familje. Megjithatë, ky studim i rastit pasqyron që mund të mbetet boshllëk ndërmjet legjislacionit të Kosovës për dhunën në familje dhe zbatimin e ligjit në praktikë. Ai nënvizon nevojën për përmirësimin e përgjigjeve dhe të bashkërendimit në emër të institucioneve përkatëse për ta garantuar sigurinë e viktimës, për ta parandaluar mosndëshkimin për dhunë në familje dhe për ta lehtësuar zbatimin e ligjit.

Figure 4. Timeline of Case 'X'



PËRFUNDIM

Ky studim ofron një pasqyrë të përgjithshme lidhur me gjendjen aktuale të përgjigjeve të PK-së dhe të Prokurorive Themelore të Kosovës lidhur me dhunën në familje në Kosovë. Pas analizimit të intervistave, të një pyetësi dhe një studimit të rasti, propozimi për PK-në është që t'i shfrytëzojë shumë prej përgjigjeve ndaj dhunës në familje që janë saktësuar nga legjislacioni përkatës i Kosovës dhe PSO. Për më tepër, njësitë për dhunë në familje brenda PK-së ofrojnë përgjigje të dobishme të specializuar ndaj këtij fenomeni. Në kuadër të Departamenteve të Përgjithshme të Prokurorive Themelore të Kosovës, caktimi i personave kontaktues për dhunë në familje siguron themelin për një përgjigje të specializuar të prokurorëve lidhur me krimet e kryera në kuadër të dhunës në familje. Prandaj, ka dëshmi për praktikë të mirë që ka për qëllim mbështetjen e viktimave për të pasur qasje në mbrojtje, mbështetje dhe shpërblim.⁷² Megjithatë, ky studim po ashtu tregon që është i nevojshëm standardizimi i praktikave të mira brenda këtyre institucioneve të sundimit të ligjit në mënyrë që të përfundojë në mënyrë të besueshme mosndëshkimi për dhunën në familje. Bashkërendimi, mbledhja e të dhënave, trajnimi dhe mbështetja e viktimave janë temat kryesore në të cilat nevojitet përparim. Për t'i marrë këto masa, PK dhe Prokuroritë Themelore të Kosovës mund ta sigurojnë ofrimin në rritje të shërbimeve, të përqendruara në viktimën dhe që marrin parasysh çështjet gjinore, për viktimat e dhunës në familje. Viteve të fundit, janë ndërmarrë nisma të shumta për përmirësimin e përgjigjes ndaj dhunës në familje në Kosovë. Megjithatë, përkundër këtyre përpjekjeve, mënjanimi i dhunës në familje mbetet sfida për të gjitha institucionet e përfshira në proces. Faktorët historikë dhe kulturorë ndikojnë në dhunën kundër grave dhe duhet të trajtohen përmes disa mënyrave të ndryshme përfshirë përmirësimin e përgjigjes së institucioneve të sundimit të ligjit, rritjen e vetëdijesimit dhe shërbimet plotësisht të disponueshme për viktimat dhe kryesit e veprës. Në përgjithësi, përkushtimi dhe bashkërendimi i të gjitha institucioneve e përfshira në përgjigjen ndaj dhunës në familje mund të jetë të dobishme për secilën grua, burrë dhe fëmijë në Kosovë. Siç tha një pjesëmarrës i studimit nga PK-ja, 'familja e shëndoshë çon tek Kosova e shëndoshë'. Ky raport ofron disa rekomandime specifike për PK-në, Prokuroritë Themelore

⁷² Sektori i Kombeve të Bashkuara për avancimin e grave. *Praktikat e mira në luftimin dhe mënjanimin e dhunës kundër grave: Takimi i grupit të ekspertëve*. Mund të gjendet në internet, faqe 4.

të Kosovës dhe aktorët e tjerë si përpjekje për t'i nxitur zhvillimet pozitive në përgjigjet e sundimit të ligjit dhe ato institucionale ndaj dhunës në familje në Kosovë.

REKOMANDIMET

Rekomandimet për Policinë e Kosovës

1. Legjislacioni i Kosovës që ka të bëjë me dhunën në familje dhe *Procedurat Standarde të Operimit për Dhunën në Familje në Kosovë* duhet të bëhen funksionale në mbarë forcën e Policisë së Kosovës. Është imperativ që të gjithë aktorët, nga oficerët patrullues deri te hetuesit e specializuar për dhunë në familje, të veprojnë në pajtim me këto ligje dhe mjete. Trajnimi i rregullt dhe PSO, të ilustruar me shembuj praktik të përgjigjes në rast të dhunës në familje, mund ta përmirësojnë standardizimin e praktikave të mira dhe ta eliminojnë mundësinë për mospërputhje në përgjigje për shkak të karakteristikave individuale të policit.
2. Në secilin stacion duhet të krijohen dhomat e specializuara për hetim për të siguruar mjedis të besuar dhe të sigurt për viktimën dhe ndonjë fëmijë që mund të jetë i pranishëm kur Policia e Kosovës t'i kryejë detyrat e saj në stacion lidhur me incidentin.
